

1 E martë, 5 prill 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuarit hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjes.

7 Z. Sekretar i Gjykatës, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i
10 Specializuar kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 [Mikrofoni çaktivizuar].

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëdita, të gjithëve. Zyra e
14 Prokurorit të Specializuar përfaqësohet sot nga Prokurori,
15 Cezary Michalczuk; nga Line Pedersen, Menaxhere e Lëndës; dhe
16 nga unë, Silvia D'Ascoli, Ndhmësprokurore.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Mbrojtësja e Viktimave, keni fjalën.

19 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirë. Faleminderit. Mirëdita, të
20 nderuar Gjykatës. Mirëdita të gjithëve. Viktimat pjesëmarrëse
21 në këtë çështje gjyqësore përfaqësohen nga Brechtje
22 Vossenber, bashkëmbrojtëse ime; dhe nga unë vetë, Anni Pues,
23 si mbrojtëse.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, e nderuar Gjykatëse.

3 Mbrojtja përfaqësohet nga z. Betim Shala, bashkëmbrojtësi im;

4 nga z. Fatmir Pelaj, përkthyes dhe hetues; nga unë, Julius Von

5 Bone. Dhe në sallë është i pranishëm dhe z. Mustafa, i

6 akuzuari.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

8 mirë. Faleminderit.

9 Për procesverbalin, ky proces zhvillohet përpara Trupit

10 Gjykues numër I.

11 Do të dëgjojmë dëshminë e Dëshmitarit të Mbrojtjes me

12 numër 700. Me emër Bislim Nreci. Mund të fillojmë menjëherë.

13 Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqërohemi dëshmitarin

14 të hyjë në sallë.

15 [Dëshmitar hyn në sallën e gjyqit]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

17 Nreci, mirëmëngjes. Mirë se keni ardhur në Dhomat e

18 Specializuara. Më dëgjoni?

19 DËSHMITARI: Po. Mirë se ju gjeta dhe faleminderit shumë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pikë

21 së pari, si jeni?

22 DËSHMITARI: Jam mirë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

24 mirë. Faleminderit.

25 Do të fillojmë sot me dëshminë tuaj, Z. Nreci. Jeni

1 thirrur të dëshmoni përpara të Dhomave të Specializuara në
2 çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Salih
3 Mustafës për të ndihmuar Trupin Gjykses të marrë një vendim.

4 Pasi të keni bërë deklaratën solemne, do t'ju bëjnë
5 pyetje, në fillim Avokati Mbrojtës i z. Mustafa, që është ulur
6 në të djathtën tuaj; pastaj përfaqësuesit e Prokurorisë, që
7 janë ulur në të majtën tuaj, ata me togën ngjyrë të purpurt;
8 dhe pastaj Mbrojtësja e Viktimave që është ulur më pranë jush;
9 në fund, do t'ju bëjnë pyetje dhe anëtarët e Trupit Gjykses që
10 janë ulur përpara jush.

11 Dëshiroj t'ju jap disa udhëzime sesi t'u përgjigjeni
12 pyetjeve të cilat do t'jua bëjnë. Dëgjoni me kujdes.

13 Duhet ta dëgjoni me kujdes secilën pyetje. Nëse nuk e
14 kuptoni, lirisht mund të kërkoni që personi që ua bënë pyetjen
15 t'jua përsërisë pyetjen.

16 Se duam të na tregoni të vërtetën, të na thoni se çfarë
17 keni parë, çfarë keni përjetuar, çfarë keni ndjerë. Nëse e
18 keni marrë vesh përmes ndonjë mënyre tjetër, na e thoni dhe na
19 e shpjegoni sesi.

20 Mund të mos ju kujtohen të gjitha hollësitë dhe nuk ka
21 asgjë të keqe në këtë rast të thoni "Nuk më kujtohet" apo "Nuk
22 e di".

23 Ju lutem, përgjigjuni pyetjeve, mos ju shmangni asaj që
24 ju bëhet si pyetje. Do t'ju ndërpres nëse devijoni, pra, nëse
25 i shmangeni diskutimit.

1 Ju rikujtoj se mund të kundërshtoni të jepni dëshmi për
2 gjëra të cilat mund t'ju fajësojnë në përputhje me rregullën
3 151, paragrafi 1 i Rregullores. Këtë të drejtë e keni.

4 I kuptuat të gjitha këto, z. Nreci?

5 DËSHMITARI: Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
7 mirë. Gjithashtu dëshiroj t'ju jap disa këshilla praktike për
8 dëshminë tuaj.

9 Gjithçka që themi këtu përkthehet dhe regjistrohet. Pra,
10 është e rëndësishme që të flisni afër mikrofonave që keni
11 përpara, të flisni qartë dhe të flisni ngadalë. Sepse kjo u
12 jep mundësi përkthyesve që të përkthejnë gjithçka.

13 Një gjë tjetër që është shumë e rëndësishme. Duhet të
14 filloni të flisni vetëm pasi të ketë mbaruar personi që jua
15 bën pyetjen. Domethënë, kur t'ju bëhet një pyetje numëroni me
16 veten tuaj, domethënë, pa zë deri në pesë dhe vetëm pastaj
17 mund ta jepni përgjigjen. Ngul këmbë tek kjo sepse është shumë
18 e rëndësishme kjo në mënyrë që ne t'ju ndjekim siç duhet atë
19 që thoni. Sepse nuk duam që të ketë mbivendosje midis
20 përkthimeve dhe folësve.

21 Nëse unë do ta ngre dorën kështu, atëherë mbarojeni
22 fjalinë që keni nisur dhe pastaj mos flisni më.

23 Ndonjëherë do t'ju kërkojmë që t'i hiqni ndëgjueset ose
24 madje edhe t'ju shoqërojmë të dilni nga salla, kjo do të jetë
25 e nevojshme kur ne do të kemi nevojë të diskutojmë për

1 dëshminë tuaj sepse nuk duam t'ju influencojmë në këtë dëshmi.

2 Nëse keni pyetje, nëse keni nevojë për pushim, nëse keni
3 nevojë për diçka tjetër, mjafton të ngrini dorën dhe unë do
4 t'ju jap fjalën në mënyrë që ju të shpreheni se çfarë keni
5 nevojë.

6 I kuptuat të gjitha këto?

7 DËSHMITARI: Po.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
9 mirë, z. Nreci.

10 Një pyetje tjetër: Anglisht a flisni, z. Nreci?

11 DËSHMITARI: Jo.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
13 Shumë mirë.

14 Si me çdo dëshmitar, do t'ju kërkoj tani që të lexoni
15 deklaratën solemne për të thënë të vërtetën. Ju rikujtoj se
16 është vepër penale në juridiksionin e Dhomat e Specializuara
17 dhënia e dëshmisë së rreme.

18 E kuptuat?

19 DËSHMITARI: Po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
21 Asistente e sallës, ju lutem ndihmoheni dëshmitarin me
22 deklaratën solemne.

23 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime
24 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të
25 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe

1 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

2 DËSHMITARI: BISLIM NDRECI

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit, z. Nreci. Tani jeni nën betim për të thënë të
5 vërtetën.

6 Mund të fillojmë tani me dëshminë e z. Nreci, duke
7 filluar me pyetjet që do t'ia bëjë Avokati i Mbrojtjes.

8 Z. Avokat, keni vlerësuar dy orë. Z. Shala, po. Keni
9 vlerësuar dy orë për pyetjet që do jua bëni këtij dëshmitari.
10 Si zakonisht, ju lutem informoheni Trupin Gjykes për çdo
11 ndryshim për qëllime të planifikimit. Faleminderit.

12 Keni fjalën.

13 Z. SHALA: [Përkthim] Faleminderit.

14 Pyetje nga z. Shala:

15 Py. Mirëmëngjesi, z. Dëshmitar.

16 Pë. Mirëmëngjesi.

17 Py. Z. Dëshmitar, ku jetoni sot?

18 Pë. Jetoj në fshatin Barilevë, i cili i përket Komunës së
19 Prishtinës.

20 Py. Edhe pse kanë kaluar gati 23 vite, a ju kujtohet gjatë
21 luftës në Kosovë ku keni jetuar?

22 Pë. Po. Kemi jetuar në të njëjtin fshat atëherë, jetojmë edhe
23 tani.

24 Py. Do të doja që me ju sot të bisedojmë për periudhën e
25 luftës e posaçërisht për periudhën mars-prill të vitit 1999.

1 Gjatë periudhës së muajit mars-prill të vitit 1999, a ju
2 kujtohet si ka qenë gjendja e sigurisë në fshatin e ju, ku
3 keni jetu, në Barilevë?

4 Pë. Po na kujtohet sepse ka qenë edhe në atë kohë edhe para
5 asaj kohe, lufta veç mbërrini edhe në pjesën tonë ku neve
6 jetonim dhe vepronim. Dhe ka qenë shumë e rëndë shumë me halle
7 të mëdha.

8 Py. Sa është i madh --

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një
10 moment. Dua t'ju rikujtoj edhe avokatin edhe dëshmitarin që
11 gjithmonë të prisni pasi, në rastin tuaj, pra, pasi të
12 përfundojë pyetja, po edhe në rastin tuaj, pasi të përfundojë
13 përgjigja, të krijoni një pauzë të shkurtër. Sepse kështu mund
14 t'ju ndjekim më mirë.

15 Z. SHALA:

16 Py. Për sa i përket popullsisë, a ju kujtohet sa ka qenë i
17 madh në atë kohë, sa popullsi ka pasë fshati Barilevë, në
18 numër?

19 Pë. Po dikun banorë e rezidentë atëherë i ka pasë rreth 4500
20 ose aty dikund 600. Dhe është, për fat të mirë, janë -- nuk ka
21 shpërngulje prej aty.

22 Py. Po në fshatin e ju, a ka pasë ushtarë të Ushtrisë
23 Çlirimtare të Kosovës që kanë vepruar dhe kanë jetuar në atë
24 fshat?

25 Pë. Po, ka pasë.

1 Py. A mund ta dini sa ka qenë përafërsisht numri i tyre?

2 Pë. Po numri fillimisht, çdo herë edhe sikur te neve, çdokund
3 ka fillu një numër i vogël dhe gradualisht është shku duke u
4 rritun. Kështu që në atë periudhë, për të cilin ju flisni,
5 dikun kemi qenë afër 30.

6 Py. Kur thua "kemi qenë", a do të thotë kjo që dhe ju keni
7 qenë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

8 Pë. Po, ekzakt është ashtu. Edhe jam shumë krenar. Dhe
9 mburrem shumë me atë kohë të periudhës që kam pasë mundësi me
10 e ndihmu popullatën dhe vendin.

11 Py. Po kjo -- e cekët numrin prej 30 ushtarëve. A ka qenë
12 njësi, a ka pasë ndonjë emër kjo njësi, ky grupi i ushtarëve?

13 Pë. Është pak ma gjenë. E nderuara Kryetare e Trupit Gjykues,
14 neve, duhet një fiije pak ma gjanë, një minutë do ju marrë.
15 Sepse nuk ka qenë -- kjo ka qenë ushtri vullnetare. Nuk ka
16 qenë ushtri sikur shtetet tjera që e kanë ushtri të rregullt
17 dhe detyruese. Prandaj neve kemi qenë ushtri vullnetare, po në
18 të njëjtën kohë kemi qenë edhe ushtri humanitare. E them
19 "vullnetare" edhe jo e detyruar sepse shtetet e mëdha kanë
20 ushtrinë e detyruar. Dhe kanë një godinë ushtarake, kanë
21 mjetet ushtarake, kanë armatimin ushtarak edhe veshmbathjen.
22 Neve nuk i kemi pasë asnjërën prej tyre. Prandaj jemi kenë
23 humanitarë me armët e tona të blera.

24 Py. Z. Dëshmitar,

25 Pë. Them humanitare --

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
2 pyetja ishte: A ishit një njësi dhe kjo njësi, nëse po, a
3 kishte emër? Unë ju lejova që ta shtjellonit, të shpjegonit më
4 shumë por më për më kjo nuk ishte përgjigja.

5 Për herës tjetër, thjesht përgjigjuni pyetjes. Po të kemi
6 nevojë për sqarime, do t'jua bëjmë pyetjen për sqarim, do jua
7 kërkojmë sqarimet.

8 Por në këtë rast është a ishit njësi dhe, nëse po, a
9 kishte emër kjo një si.

10 DËSHMITARI: Në atë kohë nuk janë vnuar shumë emra, po ka
11 qenë një grup prej 20 ushtarësh fillimisht, tani, pastaj çdo
12 ditë duke u rrit dhe kemi mbërri aty. Dhe dikun ka fundi i
13 prillit ose mesi i prillit, a dikun, e kemi marrë emrin njësia
14 në emën të fshatit, Njësia e Barilevës.

15 Z. SHALA:

16 Py. Njësia e Barilevës në kuadër -- a ka qenë në kuadër të
17 ndonjë brigade?

18 Pë. Po.

19 Py. Në kuadër të cilës brigadë?

20 Pë. Ka qenë në kuadër të Brigadës 153.

21 Py. Kjo njësi a e ka pasë udhëheqësin e vet, komandantin e
22 vet?

23 Pë. Po.

24 Py. Pasi më herët e cekët se njësia ka qenë e përbërë nga
25 vullnetarët, qytetarët e fshatit të Barilevës. Komandanti i

1 kësaj njësie a ka qenë a ka qenë i atij fshati apo ka qenë nga
2 ndonjë fshat tjetër?

3 Pë. Jo, nuk ka qenë i këtij fshati. Se gjeografikisht me
4 pjesën ku ka veprue njësia jonë dhe Brigada 153,
5 gjeografikisht, është bukur larg.

6 Py. Jo. Pyetja ime ishte: Komandanti i njësisë, a ka qenë i
7 atij fshati, i Barilevës?

8 Pë. Jo.

9 Py. Nga cili fshat ka qenë komandanti?

10 Pë. E keni fjalën për të Brigadës apo të njësisë?

11 Py. Jo. Për njësinë po flas?

12 Pë. A mirë. E kuptova. Ka qenë i fshatit Dardhishtë, Komuna e
13 Obiliqit, tani Kastriot.

14 Py. A ju kujtohet, kush e ka caktu atë si komandant të kësaj
15 njësie në fshatin e Barilevës?

16 Pë. Nuk e kemi pyetur kështu në aq hollësi sepse nuk na u ka
17 dhanë. Nashti mundësia na u ka dhënë çdo herë, po neve i kemi
18 vepru aty dhe nuk na u ka deshtë ajo punë për atë.

19 Py. Ju personalisht a keni jetuar gjatë tërë kohës së luftës
20 në fshatin e Barilevës?

21 Pë. Po.

22 Py. Në asnjë moment --

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

24 Avokat, një moment. Kam një pyetje sepse mbetet e paqartë.

25 Ju nuk e bëtë e si pyetje, po, në fakt, dua që ta bëj unë

1 tani këtë pyetje.

2 Kush ishte komandanti i kësaj njësie?

3 DËSHMITARI: Ishte Jusuf Shalaku.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Faleminderit.

6 Z. SHALA:

7 Py. Thatë që keni jetu në fshatin e Barilevës gjatë tërë
8 kohës së luftës, domethënë, kjo që në asnjë moment nuk e keni
9 lëshuar këtë fshat?

10 Pë. Jo. Fshatin nuk e kemi lëshuar, po jemi kanë të detyruar
11 lagjet me i ndërrue. Se Barileva shtrihet në një pjesë shumë e
12 gjënë dhe ka pasur mundësi prej një lagje në një lagje tjetër.
13 Jo me nejtë tanë kohën me një lagje.

14 Py. Cila ka qenë ajo arsye që e keni braktisur ju lagjen ku
15 keni jetuar?

16 Pë. Aty kanë qenë dy arsye. Arsyeja e parë ka qenë për shkaqe
17 të sigurisë tonën ma së pari dhe të popullatës që kanë qenë
18 aty, për mos me u identifikue se janë edhe ushtarët në mesin e
19 tyre. E dyta, ka qenë një lagje, e cila quhet lagja Verbovci,
20 që është shumë afër me fshatin Vranidoll, që lidh pjesën e
21 Gollakut dhe aty është dashtë me u bë transferimi i njerëzve
22 civil prej pjesës së Llapit që neve jetojmë. Dhe duhet me
23 kalue hekurudhën, lumin, rrugën dhe e lidh pjesa e Gollakut.

24 Për atë dhe kemi pasë dy arsye që neve kemi nejtë me
25 javë, me ditë, me orë në atë lagje.

1 Py. E thatë që është dashtë të bëhet transferimi i popullatës
2 nga një pjesë në pjesën tjetër. Këtë transferim, a e keni
3 ndihmu ju si ushtarë apo si ka funksionu ky transferim? Kush
4 është bërë -- kush e ka bërë këtë transferim?

5 Pë. Po pikërisht neve e kemi bë.

6 Py. A do të thotë kjo që njëra ndër detyrat e juaja si ushtar
7 ka qenë transferimi popullatës prej një pjese të Kosovës në
8 pjesën tjetër apo në atë vend, prej një regjioni në një
9 regjion?

10 Pë. Po. E saktë është ashtu. Sepse neve i kemi pasë edhe
11 vëzhguesit, të cilët kanë qenë në pikat më të nalta, të cilat
12 kanë mujt me u vëzhgue njësitë paramilitare dhe militare serbe
13 që të mos na i dëmtojnë popullatën.

14 Neve i kemi grumbullue në lagje tonë ditën ata që kanë
15 tentue me kalue ka lindja ose anasjelltas dhe i kemi ndalu
16 aty. Aty kur ka mbërri mbrëmja, i kemi nis kolonë, natyrisht
17 me sigurimin pjesëtarëve tonë, se forcat serbe i kemi pasë
18 shumë afër. Dhe për mos na u dëmtue, i kemi kalu në mënyrë të
19 qetë dhe kanë kalu.

20 Prej tanë, përtme dy muajve vetëm një viktimë e kemi në
21 atë pjesë. Do të thotë, që kemi kalue shumë sigurt. Njerëzit,
22 kanë kalu, politikanë kanë kalue, njerëz civilë, gra, fëmijë,
23 pleq. Kemi pasë raste edhe kufoma me kalu prej një pjese në
24 një pjesë tjetër.

25 Py. Po cila ka qenë arsyeja që popullata në atë numër ka bërë

1 lëvizje prej një pjese në një pjesë tjetër?

2 Pë. Arsyet? Ka pasë shumë arsye. Po një prej tyre ka qenë
3 mbas 25 marsit, forcat serbe në një farë forme u shfrenuan.
4 Aty tani na u pakue ushqimi, na u pakue veshmbathja. Flas për
5 popullatën. Edhe aty u detyrojshin me ik prej një pjese
6 tjetër. Se pjesa e Llapit, dikun përfshihet prej aty ku neve
7 jemi edhe deri në Podujevë, dikun i kanë 27 kilometër si vijë
8 rrugore dhe tokësore dhe kështu që ka lagje, ka fshatra shumë.
9 Aty u sillshin. Aty. Për me kalu në Prishtinë, u dashtë aty
10 pare me kalue.

11 Py. Po kjo pjesë e popullatës nga Barileva, pasi siç po e
12 kuptoj unë kjo paska qenë një lloj udhëkryqi. A ka dalë edhe
13 ndonjë, përveç Prishtinës edhe në ndonjë pjesë tjetër të
14 Kosovës?

15 Pë. Po jo s'ka mujtur. Ka mujtë nga pjesa e Prishtinës me
16 kalu në pjesën e Podujevës, që i themi neve Llapit. Ose prej
17 Llapit me dalë në pjesën e Prishtinës, me kalu nëpër Gollak e
18 me u fut në Prishtinë. Dhe pjesë të tjera nuk ka pas mundësi,
19 shembull, ta marrim prej Drenicës s'ka mundësi me ardhë aty.
20 Rastësia është gjithçka po noj mik, noj kështu i rastit, se
21 jo.

22 Py. E cekët datën 25 mars, koha kur ushtria serbe dhe policia
23 serbe një farë mënyre kanë fillu me agresivitet ma të madh.

24 Pse e cekët këtë datë? Pse bash prej 25 marsit?

25 Py. Pse e kem datën, veç një datë ma para, që duhet të vdesmi

1 e mos ta harrojmë. Edhe jemi shumë falënderues tanë jetën, 24
2 marsit dhe NATO-s. Na përkrahi aq shumë dhe na u bashkue dhe
3 jemi sot këtu ku jemi.

4 Py. Dhe çka ka ndodhë më 24 mars që ju falenderut NATO-s?

5 Pë. Për neve si Ushtri Çlirimtare e Kosovës e fituam edhe një
6 mik shumë të madh me armatim shumë madh dhe të përsosun dhe e
7 bombardoi Serbinë nga ajri.

8 Py. Gjatë periudhës mars-prill të vitit 1999, në territorin e
9 fshatin të Barilevës, përveç që e përmendët që një person
10 paska vdek apo është vra, a ka pasë edhe persona të tjerë të
11 vramë gjatë asaj periudhe?

12 Pë. Po, i kemi 11 të vramë.

13 Py. Këta 11 persona janë vra gjatë luftimeve apo si ka ardhur
14 deri te vrasja e tyre?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

16 Avokat, ju lutem bëni pyetje të hapura mos përfshini
17 përgjigjen në pyetje. Mund të thoni si vdiqën këta persona dhe
18 pastaj mund të thotë dëshmitari në luftë a në luftime ose
19 çfarëdo.

20 Z. SHALA:

21 Py. Si ka ardhë deri tek vdekja e këtyre personave? Çfarë
22 forme?

23 Py. Po këta 8 prej tyre kanë qenë të paarmatosun dhe kanë
24 qenë civilë. Këta i kanë vra gjatë rrugëtimit prej një fshati
25 në fshatin tjetër. Po janë vra në Barilevë. Tre kanë qenë

1 ushtarë. Njëri prej tyre ka qenë profesor. Ai është vra më 20
2 mars. Është Selim Berisha i ndjeri, profesor. Dhe dy të
3 tjerët, ata janë vrarë njëni u vra në Penuh të Podujevës, po
4 ka qenë pjesëtar i njësisë tonë dhe tjetri në fshat.

5 Py. A ju kujtohet periudha kur këta dy personat, këta dy
6 ushtarët janë vra?

7 Pë. Për të fundit më kujtohet se ka qenë 18 maji dhe çdo herë
8 e vizitojmë familjen e tij dhe ka qenë komandant togu i një
9 njësie të Brigadës 151.

10 E të dytin, një Veton Ibrahimin, saktë me datë nuk më
11 kujtohet, por në mes të 20 marsit dhe 18 majit, aty dikund po
12 ekzakt më vjen shumë keq që nuk e mbaj mend.

13 Py. E përmendët që e keni braktisun atë lagjen ku keni jetuar
14 ju keni kalu në pjesën tjetër të fshatit. A ju kujtohet data
15 kur ka ndodhë ajo?

16 Py. Po data saktë kështu nuk kemi, se neve kemi lëvizë, nuk
17 kemi ndejtë vetëm në Barilevë, në lagjen Llumnica, që është
18 afër lagjes Verbovci dhe aty e kemi pasë njësinë vëzhguese. Se
19 neve gjeografikisht jemi lidhë ma tepër me Brigadën 151 se me
20 153. Kemi qenë pjesë e 153-shit, mirëpo gjeografikisht edhe
21 fizikisht, kemi veprue në territorin e Brigadës 151. Edhe për
22 atë na u është dashtë se jemi vendosë, kemi qenë të urdhëruar
23 me nejtë në të dy lagjet. Lagja Llumnica për vëzhgim se është
24 në naltësi mbi detar bukur e mirë dhe prej aty është duk dhe
25 pjesa e Vushtrrisë, pjesa e Prishtinës dhe e Podujevës.

1 Kurse lagja e Verbovcit ka qenë adekuate për të transportuar
2 njerëzit nga Gollaku në Llap dhe nga Llapi në Gollak.
3 Py. Këta dy personat që janë vra, a ju kujtohen me emrat e
4 atyne dy personave? I dini emrat e atyne dy personave, përveç
5 profesorit?

6 Pë. Po.

7 Py. Si i kanë pasë emrat?

8 Pë. Është Nexhmi Llumica, i quajtur Gjoni. Është vra më 18
9 maj 1999. Dhe Veton Ibrahim, që dhe njëherë e them me shumë
10 keqardhje, që datën nuk e di, po është Veton Rexhep Ibrahim.

11 Z. SHALA: Znj. Kryetare, dëshiroj që dëshmitarit t'ia
12 paraqes deklaratën e dhënë të Mbrojtjes së Salih Mustafës në
13 mënyrë që t'ia rifreskoj një ngjarje për të cilën ai ka fol
14 gjatë asaj deklarate.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
16 lutem, mund të vazhdoni, z. Avokat.

17 Z. SHALA: Faleminderit. Z. Oficer i Gjykatës, ju kisha
18 lut që të paraqitni dokumentin DSM00056-00067. Deklarata në
19 gjuhën angleze dhe dokumentin DSM00716-00726 deklaratë në
20 gjuhën shqipe. Të paraqitni faqen 5 të deklaratës në gjuhën
21 shqipe dhe po ashtu faqen 5 të deklaratës në gjuhën angleze.

22 Py. Z. Dëshmitar, gjatë intervistimit nga ana e Avokatit
23 Mbrojtës të Salih Mustafës më datë 22 mars të vitit 2021, ju
24 përveç këtyre dy personave që i përmendët sot këtu, në atë
25 kohë keni përmend dy persona të tjerë.

1 Dhe me atë rast, në pyetjen avokatit:

2 "Kush ishin këta dy persona që vdiqën atë ditë?"

3 Ju keni deklaruar:

4 "Kanë qenë Bedri Kurti dhe i dyti është dikush me
5 mbiemrin Kaçiu. Nuk ja di emrin pasi ai ishte me origjinë nga
6 një fshat tjetër".

7 A ju kujtohet që keni deklaruar kështu atë ditë?

8 Pë. Po. Mirëpo ka një -- është një ndërhyrje e vogël. Nuk
9 është 22 marsi, se e kam thënë më 22 mars --

10 Py. Z. Dëshmitar, nuk e përmenda datën. Vetëm i përmenda këta
11 dy persona. Ai i keni përmend këta dy persona me emër, mbiemër
12 dhe vetëm mbiemër?

13 Pë. Po. Po.

14 Py. Dhe a është e vërtetë që këta dy persona kanë vdekë në
15 Barilevë? përkatësisht çka ka ndodhë? Si ka ndodhë deri këta
16 persona që i keni përmendë?

17 Pë. Po, këta kanë vdekë më 12 prill. Sepse aty ku neve rrinim
18 në lagjen Barileva dhe të Verbovc, dikun rreth orës 18.30 na u
19 kanë ofrue simbas vëzhguesve të cilët kanë qenë na kanë
20 lajmëru se po afrohen forcat serbe rreth lagjes. Dhe neve jemi
21 mobilizue shumë shpejt. I kemi largue popullatën e asaj
22 lagjes. Nuk ka pasë ku me ditë sa shumë në numër. Dikun rreth
23 200, 300. Janë largue të gjithë, derisa kanë mbërri ata në një
24 periudhë 10 minutëshe. Ashtu janë largue dhe aty jemi
25 ballafaque me forcat serbe. Do të thotë, neve, ushtarët e

1 Ushtrisë Çlirimtare.

2 Py. Këta dy persona, a kanë qenë pjesëtarë të Ushtrisë
3 Çlirimtare të Kosovës?

4 Pë. Jo. Këta dy persona -- ata nuk e dimë ekzakt se nuk ka --
5 tash ata kanë vdekë dhe nuk na ka pasë kush na tregon krejt
6 saktë. Por simbas disa fëmijëve aty që kanë qenë, i kanë pa,
7 se këta i kanë kidnapu dhe i kanë kapë më herët dhe i kanë
8 marrë me vete deri te lagja. Kështu që kur neve jemi
9 ballafaquar me ta, ata në hakmarrje dhe në ikje e sipër, i
10 kanë vra këta të dy dhe e kanë plagos lehtë një plak.

11 Py. Faleminderit. E cekët datën 22 mars para se me e dhanë
12 përgjigjen në pyetjen time. Pse e përmendët këtë datë? 22
13 prill. Më fal.

14 Pë. Jo, e kuptova. Gabimisht, se jo nuk pata ndonjë kështu se
15 është 12 prill. Se e kam përmend nashti në deklaratën e parë
16 të Avokatit, atëherë ka qenë një ngatërrim me data. Mirëpo,
17 puna e Avokatit e ka qit taman aty ku ka qenë. Nuk ka qenë më
18 22 prill, po ka qenë më 12 prill. Se e ka marrë fotografinë në
19 muralet ku janë të varrosun.

20 Py. Çka kanë paraqit ato fotografi? Më fal, para se të
21 përgjigjesh sa fotografi kanë qenë?

22 Pë. Kanë qenë dy.

23 Py. Edhe ç'ka kanë paraqit, çka është paraqit në ato dy
24 fotografi?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Prisni, prisni, ju lutem.

2 Nuk shikoj fotografi.

3 Z. SHALA: [Përkthim] Unë thjesht në fillim e pyes për
4 fotografitë, pastaj do ja tregoj.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ne
6 nuk e dimë se për ç'fotografi e keni fjalën sepse nuk e keni
7 bërë prezantimin.

8 Z. SHALA: [Përkthim] Ai po fliste për fotografitë. Ai po
9 i fliste Mbrojtjes, i ka thënë Mbrojtjes -- ekipit të
10 Mbrojtjes se po kishte bërë fotografi të varrit dhe në bazë të
11 kësaj kemi ardhur tek data 12 prill -- 20 prill 1999.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
13 unë po shikoj transkriptin, po mbase mund të thoni se ku flet
14 për fotografitë në transkript.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Më falni, e nderuar Gjykatëse.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
17 znj. Prokurore. Keni fjalën.

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] E kuptoj se ku po del Avokati,
19 besoj dhe Trupi Gjygues e di. Por nuk është bërë pyetja për
20 këtë dhe përgjigje nuk ka në procesverbal.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
22 unë këtë po them, po kisha një dyshim.

23 Z. SHALA: [Përkthim] Mora informacion që dëshmitari i
24 përmendi fotografitë. I përmendi më herët por nuk është në
25 transkript.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
2 atëherë nuk është në transkript. Kështu që duhet t'i kthehemi
3 transkriptit, duhet të bëni pyetjen. Se unë tani për tani nuk
4 di për këtë. Nëse kolegu mund të tregojë se ku është problemi
5 me përkthimin, mund t'i kthehemi asaj pyetjeje dhe të
6 përpiqemi që të shohim sepse nuk është në transkript dhe duhet
7 të ishte në transkript.

8 Faleminderit, znj. përkthyes. Po.

9 Ose mund të bëni pyetje dhe mund ta nxirrni tani.

10 Z. SHALA:

11 Py. E përmendët datën 22 prill dhe e përmendët datën 12
12 prill. Çka kanë rëndësi këto dy data që i përmendët?

13 Pë. Këto dy data secila e ka rëndësinë e vet. Se 12 prill na
14 kanë sulmue në atë lagje, në fshatin Barileva në lagjen e
15 Verbovcëve dhe i kemi aty dy viktimë që i kemi dhe një plagosje
16 të lehtë. Kurse data 22 prill, na kujton që janë kthye prapë
17 prej asaj date - tani nuk ka pasë aty forca serbe afër - po
18 janë kthye më datën 22. Edhe na i kanë mbyllë aty dy rrugë ose
19 atë rrugë të vetme që e kemi pas, për me i depërtu njerëzit,
20 për me i kalue prej një pjesë në pjesën tjetër dhe kemi mbetë
21 shumë keq.

22 Py. Faleminderit.

23 Z. SHALA: Znj. Kryetare, dëshiroj që dëshmitarit edhe
24 njëherë t'ia paraqes deklaratën që i ka dhënë Mbrojtjes në
25 mënyrë që t'ia rifreskojë pak kujtesën për atë çka ka

1 deklaruar atë ditë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
3 lidhje me?

4 Z. SHALA: Dhe ka të bëjë mu për faktin e këtyre
5 fotografive dhe datës 12 prillit dhe 22 prillit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
7 mirë. Mund të vazhdoni.

8 Për procesverbalin, në faqen 14, numri ERN në shqip i
9 deklaratës së dëshmitarit është përmendur, por në transkript
10 numrat janë 00626, por duhet të jenë 00726.

11 Z. SHALA: [Përkthim] Në shqip, po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo. E
13 thashë vetëm për ta pasur në procesverbal që të mos ketë
14 keqkuptim.

15 Mund të vazhdoni.

16 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

17 Z. SHALA: Z. Oficer i Gjykatës, ju lutem dokumentin
18 DSM00727-00734 në dokumentin në gjuhën shqipe dhe dokumentin
19 DSM00068 deri 00075 dokumenti në gjuhën angleze, 2 e
20 dokumentit në gjuhën shqipe. Dhe po ashtu faqja 2 e dokumentit
21 në gjuhën angleze. Faleminderit.

22 Py. Z. Dëshmitar, a ju kujtohet që pasi e keni dhënë
23 deklaratën për herë të parë -- që pasi e keni dhënë deklaratën
24 Avokatit Mbrojtës të Salih Mustafës, a i keni dhënë edhe
25 ndonjëherë tjetër deklaratë Avokatit Mbrojtës?

1 Pë. Deklaratë nuk kam dhënë, po e kemi bërë një ndryshim të
2 vogël, jo ndryshim, po e kemi -- Avokatin e falënderoj shumë
3 se e ka nxjerrë realitetin sepse neve i kemi harrue dhe datat.
4 Është një kohë shumë gjatë dhe datat i kemi harrue. Dhe datën
5 22 prill e kam ngatërru me 12 prill. Atë e kemi kthyer se
6 na ka ndihmë shumë fotografia dhe data në fotografi të varri
7 i Bedriut.

8 Py. Pasi thua që nuk ke dhënë deklaratë, po vetëm kemi
9 ndryshuar, qato ndryshime a kanë qenë në formë të shkrime? A
10 është shkruajtur për qatë përmbajtje të asaj bisede atë ditë që
11 e keni zhvillu?

12 Pë. Besoj se po. Nuk e di.

13 Py. Fotografitë që i përmendët, çka paraqitshin ato
14 fotografi?

15 Pë. Ato fotografi paraqesin datën e lindjes së të ndjerit dhe
16 paraqesin datën e vrasjes.

17 Py. A i keni pa ju ato fotografi?

18 Pë. Po, të Bedriut po. E kam pa edhe të, tani e di emrin dhe
19 të Nexhmi Kaçiut.

20 Z. SHALA: Znj. Kryetare, do të dëshiroja --

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
22 z. Avokat, se po dëgjoja akoma dëshmitarin.

23 Z. SHALA: Do të dëshiroja --

24 Ju lutem, Z. Oficer i Gjykatës, largoni këto dy
25 dokumente. Do të dëshiroja tani t'i paraqes dy dokumente të

1 tjera; përkatësisht dy fotografi të cilat i përmendi
2 dëshmitari.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
4 të vazhdoni.

5 Z. SHALA: Faleminderit.

6 Z. Oficer i Gjykatës ju kisha lut të paraqitni dokumentin
7 DSM00074.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
9 i bashkëlidhur të njëjtës deklaratë në fund.

10 Z. SHALA: Dhe dokumentin DSM00075. Të cilat dokumente
11 janë bashkangjitur edhe deklaratës së datës 19 prill 2021, të
12 këtu dëshmitarit, Bislime Ndreci.

13 Py. Z. Dëshmitar, a jeni duke i parë këto dy fotografi në
14 ekran të kompjuterit?

15 Pë. Po.

16 Py. A janë këto dy fotografi të cilat Avokati Mbrojtës ju ka
17 prezantuar ditën kur ju ka ftuar për të plotësuar deklaratën e
18 juaj?

19 Pë. Po.

20 Py. Dhe tani, a mund të na tregoni pse herën e parë kur e
21 keni dhënë deklaratën e keni përmend datën 22 prill si ditë
22 kur këta dy persona janë vra kur, në realitet, vrasja e këtyne
23 personave ka ndodhë më herët?

24 Pë. E nderuara Kryetare e Gjykatës, nuk e mendoj se është
25 ndonjë gabim shumë tepër i madh, sepse janë 23 vite mbrapa. Mu

1 tani janë 23 vite mbrapa. Dhe atëherë kur është bërë ky mural
2 i të dyve, nga familjarët e Nexhmi Kaçiut dhe Bedri Kurtit,
3 kanë qenë dikun rreth shtatë, tetë, muaj edhe e shifni këtu ka
4 ndryshim date te familjarët, të cilët e kanë humb. Është dikun
5 periudhë pesë, gjashtë muajshe kur janë vendos këta gurë dhe
6 ka ndryshim date. Po botënisht edhe zyrtarisht dihet se janë
7 vra në të njëjtin kohë. Ka mundësi një minutë njëri përpara,
8 një minutë tjetri mbrapa ose për të njëjtin minutë. Edhe këtu
9 figuron 11 prill, te Bedriu figuron 12 prill.

10 Dhe tek datat unë e kam bërë atë lloj gabimi të cilin nuk e
11 kam bërë me na një vetëdije ose me ndonjë qëllim të mundshëm por
12 harrim dhe ngatërrim i datave.

13 Py. Po a e dini dhe a ju kujtohet pas vrasjes së këtyre dy
14 personave, trupat e këtyre dy personave i kanë marrë
15 familjarët apo ku janë varros? A janë varros?

16 Pë. Po. Më kujtohet. Këto dy kufoma i kanë tërhequr në mbrëmje
17 ushtarët e UÇK-së dhe i kanë çuar në fshatin Kozaricë, është
18 afër lagjes Llumnica, po është fshat tjetër. Se atje a kanë
19 pak më qetë dhe atje u bërë varrimi i tyre. Në mbarim të luftës,
20 është bërë zhvarrimi dhe rivarrimi në vendlindjet e tyre.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

22 Avokat.

23 Z. Dëshmitar, mund t'i hiqni ndëgjueset, ju lutem.

24 Faleminderit.

25 Z. Avokat, i morëm përgjigje pyetjes a mund të na thoni

1 që pse herën e parë kur dhatë deklaratën tuaj përmendët 22,
2 datën 22? Cila ishte përgjigja? Cili ishte sqarimi apo
3 shpjegimi që i dha dëshmitari kësaj pyetjeje? Mos ishte
4 thjesht kjo përmbledhja që i kishte ngatërruar? Se unë nuk e
5 kam të qartë. Përmendi dy data të ndryshme në varre, po nuk
6 mora sqarim. Nëse e dëgjuat ju sqarimin, ma thoni se cili
7 ishte sqarimi. Përndryshe, duhet të vazhdoni ta sqaroni me
8 dëshmitarin.

9 Z. SHALA: Po, gjithsesi. Po çështja pse dëshmitari i
10 përmendi dy data ishte se unë i kam harru datat, po edhe vetë
11 familjarët në një farë mënyre i kanë harru datat se është
12 periudhë. Në qatë kuptim i ka cek. Por do ta sqarojmë edhe
13 njëherë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Dëshmitari tha, më duket dy herë
17 se i kishte ngatërruar datat. Kjo ishte përgjigja e tij.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua
19 të di pse i ka ngatërruar. Se që i ka ngatërruar kjo është e
20 qartë për të gjithë ne, po dëshiroj që të kuptoj më mirë
21 përse.

22 Znj. Prokurore.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kam një sugjerim nëse Avokati i
24 Mbrojtjes t'i përgjigjet Trupit Gjykses ta bëjë në anglisht se
25 po qe se flet në shqip, e kupton dëshmitari. Edhe pa kufje.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
2 patjetër. Faleminderit, znj. Prokurore.

3 Kështu pra, e dimë që e ka ngatërruar, po duam ta dimë
4 pse. Mund të sqarojmë këtë?

5 Z. SHALA:

6 Py. Z. Dëshmitar, deklaruat që gjatë dhënies së deklaratës
7 suaj ju, një farë mënyre, i keni përzi datat e vrasjes së
8 këtyre dy personave. Herën e parë keni dhanë datën 22 prill;
9 ndërkaq pasi që Avokati i Mbrojtës ju ka prezantuar
10 fotografitë e përmendoreve, varreve, të këtyre dy personave në
11 të cilat janë të shënuara datat e lindjes dhe të vdekjes.

12 A mund të na tregoni, në kohën kur e keni dhënë
13 deklaratën për herë të parë, pse i keni përzi këto dy data;
14 përkatësisht, pse keni mendu që kjo ka ndodhë më 22 prill?

15 Pë. Nuk a ngatërru me atë qëllimin që u ngatërrua. Po 12 me
16 22 aty nuk -- ekzakt, seriozisht nuk e di pse. Se ne aty
17 viktime kemi pasë për çdo ditë edhe datat tjera nuk -- njerëz
18 tjerë nuk është shumë që i mbaj mend. Për shkakun që këta janë
19 vra atë ditë kur na kanë sulmue. Dhe i kemi tërheq me ushtarë.
20 I kemi varros vetë. Edhe ajo është që mbahet mend pak ma
21 shumë. Mirëpo, pse u ngatërrua tani 12, 22, nuk kam ndonjë
22 arsye, nuk kam ndonjë shpjegim të asaj pune që pse.

23 Py. Faleminderit.

24 Z. SHALA: Z. Oficer i Gjykatës, ju lutem mund t'i largoni
25 këto dy dokumente nga --

1 Py. Gjatë kohës së luftimeve që i keni pasë në fshatin e
2 Barilevës me policinë dhe ushtrinë serbe, pjesëmarrës të atyre
3 luftimeve a ka qenë vetëm njësitë e Barilevës apo keni pasë
4 edhe ndonjë ndihmë nga ndonjë njësit tjetër?

5 Pë. Jo, nuk kemi pasë ndihmë prej njësive të tjera se neve
6 kemi -- nuk kemi pasë ndihmë prej njësive të tjera sepse ne kemi
7 qenë ata ushtarët e këtij fshati të cilët i kanë ndihmë
8 njësitë e tjera me djem ushtarë. Prandaj kemi qenë të vetëm,
9 djemtë e Barilevës.

10 Py. Pasi që në atë pjesë të Kosovës, përkatësisht në pjesën e
11 fshatit të Barilevës ka pasë lëvizje të mëdha të njerëzve, a
12 ka pasë edhe lëvizje të ushtarëve të UÇK-së?

13 Pë. Po, ka pasë.

14 Py. Përafërsisht, a mund ta dini me numër, sa ka mund të jenë
15 ajo lëvizje dhe zakonisht cilat rrugë i kanë shfrytëzuar?

16 Pë. Si numër është shumë e vështirë se nuk kemi shënim për atë
17 punë. Mirëpo për çdo natë ka pasur lëvizje, si nga ana e
18 Gollakut për në Llap, si nga ana e Llapit për në Gollak, sepse
19 nga Gollaku në Llap janë shku për me i ndihmu njësi tjera. Se
20 luftimet janë kanë ma të rrepta dhe janë kanë ma të gjata në
21 atë pjesën e Llapit. Dhe ata, tani në çdo dy ditë, në çdo tri
22 ditë, ai grupi i ushtarëve është kthye janë ndërrue me ushtarë
23 tjerë ma të pushueshëm dhe ma të freskum. E për atë ka pasë
24 për çdo ditë ka pasë lëvizje.

25 E them çdo ditë, sepse lëvizja aty është bë natën. Ditën

1 janë grumbulluar në pjesën tjetër dhe natën kanë lëvizë si nga
2 e djathta ashtu edhe nga e majta.

3 Py. Po e përmendët regjionin e Gollakut edhe regjionin e
4 Llapit. A nuk ka ekzistuar ndonjë rrugë tjetër për t'u shfrytëzuar
5 që nga regjioni Gollakut për me dalë në regjionin e Llapit?

6 Pë. Në atë kohë nuk ka pasë sepse aty është ngushticë. Është
7 ngushticë shumë e madhe. Ku do tjetër një kilometër me shkue
8 ma ka drejtimi i Podujevës është, menjëherë, nuk ka ma asnjë
9 ngushticë dhe është gjenësi shumë e madhe, është rrafsh. Aty
10 është shfrytëzuar ajo ngushticë, të cilën e kalon lumi,
11 hekurudha, rruga e asfaltit. Të trija janë një perimetër diku
12 rreth 100 metra.

13 Py. Ashtu siç e shpjegoni ju, rezulton që kjo pjesë përreth
14 fshatit të Barilevës paska qenë një lloj udhëkryqi, një lloj
15 rrugëkalimi kryesor. Po policia apo ushtria serbe a --

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
17 Avokat.

18 Z. Dëshmitar, ju lutem hiqini ndëgjueset.

19 Për mua nuk është e qartë. Pra, nuk është i qartë
20 konkluzioni që i sugjeroni dëshmitarit se pranë Barilevës
21 kishte një farë kryqëzimi apo kalimi kryesor. Ku e mbështesni
22 këtë?

23 Z. SHALA: [Përkthim] Dëshmitari përmendi se, pra,
24 përmendi pasi unë i bëra pyetjen nga rajoni i Gollakut për në
25 Llap dhe ai tha se ishte vetëm rruga në atë kohë që mund të

1 përdorej për të kaluar nga një rajon në një rajon tjetër.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

3 Në rregull. Mund të vazhdoni.

4 Z. SHALA: [Përkthim] Faleminderit.

5 Py. Z. Dëshmitar, a ta përsëris pyetjen apo mund ta jipni
6 përgjigjen, kur pyeta po policia serbe apo ushtria serbe a nuk
7 ka qenë e stacionuar në atë pjesë, a nuk ka kontrollue dhe atë
8 pjesë?

9 Pë. Ata qysh nuk kanë qenë. Kanë qenë, po kanë qenë nja tri
10 shpia ose katër aty pak ma në brendësi, jo në atë ngushticën,
11 po aty afër. Edhe neve ata i kemi vëzhgue 24 orë kurrë pa
12 ndërpre. Dhe për atë, e thamë edhe ma herët, janë grumbullue
13 njerëzit në lagjen Verbovci ditën, kanë kalue natën. Natën ka
14 qenë arsyeja sepse natën nuk kanë vërejtë që po depërtojmë.
15 Nuk na kanë vërejtë se jemi të armatosur a cilët i kemi
16 përcjellë. A kanë problem me u diktue se je i armatos. E tani
17 me i rrezikue edhe ata njerëz të gjorë që janë kalu aty pari.
18 Dhe vërtetë ka qenë udhëkryq shumë me rëndësi për këto dy zona
19 të Kosovës; do të thotë, për Gollakun dhe për Llapin. Se aty
20 janë transportu edhe gjena ushqimore. Jo vetëm njerëz. Po me
21 traktora, me kuaj, janë depërtu dhe gjena ushqimore prej një
22 zone në zonën tjetër, është bartë ushqimi. Do të thotë, aty ka
23 qenë arteria kryesore për këto dy zona. Për atë e mbaj mend që
24 është data 22 se na u ka mbyll. Ajo na u ka mbyll sikur po të
25 na mbyllet ajri.

1 Py. E përmendët që edhe ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të
2 Kosovës e kanë shfrytëzuar këtë rrugë. A ka qenë rasti edhe me
3 ata kështu njëjtë si me popullatën civile?

4 Pë. Po, po patjetër. Patjetër, sepse neve urdhnat gjithherë
5 nga përgjegjësit tanë i kemi marrë, se nuk duhet të shifemi
6 nga forcat armikut, se jemi afër popullatës dhe jemi të
7 armatosur dhe në asnjë mënyrë të mos bëjmë provokime sepse ata
8 mund të na revanshohen në popullatë. Dhe për ata është bërë
9 gjithherë ditën janë grumbullue, si në anën e Barilevës, ashtu
10 edhe në anën e Gollakut, atje që quhet Vranidoll, një lagje e
11 vogël dhe natën tani kur ka mbërri terri, kanë depërtue prej
12 në dy anëve.

13 Py. Ju personalisht, gjatë kësaj periudhe kohore, a i keni
14 ndihmuar njerëzit nga pjesa e Llapit të kalojnë në pjesën e
15 Gollakut?

16 Pë. Po.

17 Py. Dhe gjatë këtij rrugëtimi, zakonisht nëpër cilat fshatra
18 keni kalu?

19 Pë. Jo, nga kalimi -- nëse është bë kalimi aty për aty nuk
20 kem pasë arsye shumë të mëdhaja. Me ndonjë rast të veçantë
21 kemi mujtë me kalu ma larg, po prapë është dashtë me u kthy
22 aty te pika ku neve kemi qenë të përqëndrum. Jo, nuk ka shumë
23 fshatra aty. Është Barileva. Janë aty lumi, hekurudha, rruga
24 dhe është fshati Vranidoll. Me nonji rast kështu një herë, dy
25 herë, domethënë, që kemi kalu edhe më tutje, më larg në

1 fshatra tjera.

2 Py. Po gjatë kësaj periudhe kohore, a ka pasë raste që edhe
3 ndonjë udhëheqës apo komandat i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
4 nga një regjion të kalon në regjionin tjetër të Kosovës? Pra,
5 nga regjioni i Gollakut të kalon në regjionin e Llapit?

6 Pë. Po, gjithsesi. Ka pasë edhe pej fëmijëve, gra, pleq
7 burra, të plagosun, ushtarë, ka pasë eprorë, ka pasë
8 politikanë, gazetarë. Dhe kështu që është -- shkurt, ka
9 depërtu numër shumë i madh të profileve të ndryshme të jetës.

10 Py. Po gjatë kësaj periudhe kohore, kur e përmende një numër
11 kaq të madh të njerëzve të cilët kanë frekuentu këtë pjesë, a
12 nuk ka ndodhë asnjëherë që policia serbe apo ushtria serbe të
13 vërejnë këto lëvizje?

14 Pë. Ditën ka mujtë me i vërejtë, po natën nuk ka mujtë me na
15 vërejtë. Se ka shelnje shumë, ka pemë shumë. Edhe për atë
16 është gjetë edhe ngushtica, është gjetë edhe hapsina edhe
17 siguria. Vëzhguesit kanë qenë shumë të singërtë, kanë qenë
18 shumë aktiv. Dhe çdo lëvizje, nëse ata kanë bë lëvizje, neve
19 kemi anulue lëvizjet për atë natë dhe njerëzit kanë mbetë aty
20 deri natën tjetër. Nëse ata na kanë njoftue se nuk ka lëvizje
21 të armikut, neve kemi lëviz dhe kemi lëviz lirshëm dhe i kemi
22 kalue. Jo kaq lirshëm me atë kuptimin lirshëm, frika ka qenë
23 shumë e madhe, mirëpo, pa dëmtime.

24 Py. Po nëse është dashtë të rrinë ata njerëz një natë aty ku
25 kanë ndejtë ata njerëz?

1 Pë. Kanë ndejtë nëpër shpiat e lagjes Verbovci dhe nëpër
2 shpiat e lagjes Vranidolli. Aty janë shërbye me ushqim, me
3 ujë. Bile në pjesën e Vranidollit ka qenë edhe doktori dhe
4 infermieri.

5 Py. Ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, a ka pasë, a
6 ka ndodhë që edhe ata të rrinë?

7 Pë. Ka nejtë. Patjetër, që kanë nejtë. Po nuk kanë nejtë si
8 së bashku me pjesën civile. Se a kanë një shtëpi aty të cilën
9 na e kanë ofrue si nej, si shpi, odë, që neve atje e quajmë
10 odë dhe neve aty kemi nejtë, aty kemi hangër deri në mbrëmje.
11 Në mbrëmje dhe janë bë angazhimet për rrugën tjetër. Po jo me
12 civilët. Asnjëherë me civilë jo, se neve kemi qenë të
13 armatosun, nuk kemi qenë unifomuar, nuk kem pasur uniformë.
14 Dikush ndonjë jelek ashtu ngjyrë gri, nonji pantallon. Mirëpo,
15 jo uniformë adekuate ushtarake nuk kemi pasë për arsyen mos të
16 diktohem nga armiku se e rrezikojmë popullatën. Jo për neve
17 se neve kur kemi dalë e kemi fshef rrezikun.

18 Py. Pasi e përmendët që nuk paskeni pasë uniformë, a keni
19 pasë ndonjë shenjë në bazë të secilës jeni dalluar që jeni
20 ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

21 Pë. Jo. Sepse me atë shejë prapë kena mujtë me u diktue prej
22 forcave të armikut. Aty është kanë me rëndësi me i mdihmue
23 popullatën, se ka pasë shumë popullatë. Jo shumë, po 90 për
24 qind ose 95 për qind a kanë që nuk e kemi njoftë, as nuk na
25 kanë njoftë ata neve. Ken disa djem që na ndihmuan.

1 Faleminderit kanë shkue.

2 Py. Kjo dhoma, odë që e quajte, në cilën pjesë të fshatit
3 gjindet?

4 Pë. Gjindet në Barilevë, në fshatin -- në lagjen e Verbovcit.

5 Py. Dhe në atë odë vetëm ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare kanë
6 ndjetë?

7 Pë. Po.

8 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

9 Z. SHALA:

10 Py. Z. Dëshmitar, e përmendët odën, dhomën ku kanë ndejtë
11 ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare. Për çka shërben oda? Pse
12 ndërtohet oda nëpër fshatra?

13 Pë. Pse ndërtohet saktë nuk e di, në atë kuptimin pse. Mirëpo
14 ndërtohet për një nejt të burrave që rrinë burra, djem, rrinë
15 veç me gjininë femërore. Rrinë aty bëhet llaf bëhet, muhabet
16 bëhet. Dhe odat janë përdorë, në Kosovë janë përdorë për këtë
17 gjë. Me hangër darkë, drekë, ku ta di unë edhe nejtjen janë ba
18 aty në odë. Ajo dhomë është quajte odë. Ajo ka qenë dhomë, po
19 tashti ka qenë me përmasa pak më të madha se dhomat e
20 zakonshme dhe është quajte odë.

21 Py. E përmendët që z. Isuf Shalaku ka qenë komandant i
22 njësitit tuaj. A e dini kujt i ka raportuar dhe nga kush ka
23 marrë komanda komandanti?

24 Pë. Me thanë të drejtën për atë punë hiç fort nuk e kemi pasë
25 atë hallin se kujt po i komandon ose prej kujt po i merr. Te

1 neve, në një farë forme, pej kur kemi dalë, komandant i kemi
2 thënë secili njëri-tjetrit. "Ku je komandant? Si je komandant?
3 Ku shkon komandant? Ka vjen komandant?" Do të thotë, që jo me
4 atë kuptimin e keq të shakasë. Mirëpo nuk -- sepse pasi ka
5 qenë ushtri vullnetare nuk ka pasë ndonjë farë zyre
6 administrative të rregullt për me mbajtë aty evidenca dhe nuk
7 e di. Thjesht nuk na ka interesu shumë as ajo puna e njerëzve
8 të tjerë. Ne kemi pasë punë përpos me të. Na ka vizitue "Qysh
9 është puna? Si është? A kanë kalue shumë njerëz? A keni pasë
10 shumë halle, shumë telashe? Keni çka me hangër?" Kjo ka qenë e
11 shumta.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

13 Avokat, dua t'i bëj një pyetje dëshmitarit.

14 Ju kuptoj mirë kur thonë se "Të gjithë ishin komandantë?"
15 Domethënë, në kuptimin që "Të gjithë e thërrisnin njëri-
16 tjetrin 'komandant, komandant'" se nuk -- po përpiqem ta
17 kuptoj. A e konfirmoni sepse kështu thatë. Domethënë i
18 drejtoheshit njëri-tjetrit "komandant".

19 Të gjithë ishin komandant?

20 DËSHMITARI: Po nuk e di shumë të qartë se çka do të thotë
21 edhe fjala shumë me peshë "komandant". Mirëpo është e vërtetë
22 që i kemi thënë, i thojmë edhe tani edhe atëherë i thojmë edhe
23 tani. "Ku je, komandant?" "A po pimë kafe, komandant?" Kështu
24 një nga pa -- pa na një të keq dhe pa shaka kështu?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

1 mirë po udhëheqësit pastaj, ai që ishte kryetari, si të

2 thuash, si i drejtoheshit?

3 Pë. Po. Saktë Jusufit çdo herë -- se Cuf e kemi thirrë kështu

4 ma shpesh, po edhe me shumë më shumë hera "Hë, komandant?

5 Ç'kemi komandat? Çka ka komandant?" dhe kështu që kjo është e

6 tëra puna e komandantit.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

8 rregull. E mbajtëm shënim.

9 Mund të vazhdoni.

10 Z. SHALA:

11 Py. Në atë kohë, a e keni ditë si ka qenë e organizume

12 Ushtria Çlirimtare e Kosovës në pjesën e Llapit dhe Gollakut?

13 Pë. Po edhe te neve ka qenë e organizume sikur në tanë

14 Kosovën. Do të thotë shkak i dhunës, i represaljeve, i këtyne

15 gjënave dhe gradualisht mbërrini edhe tek neve. Pse mbërrini

16 pak ma vonë se në Drenicë e në Dukagjin, mbërrini dhe tek ne

17 edhe u detyrum, patjetër u detyrum, të bëhemi pjesë e

18 mbrojtjes së popullatës e mbrojtjes së atdheut.

19 Py. Përveç njësisë a ka pasur edhe ndonjë njësi tjetër e me

20 emërtim tjetër në kuadër të ushtrisë?

21 Pë. Për në Barilevë e ke fjalën?

22 Pë. Për pjesën e Llapit dhe Gollakut?

23 Pë. Po në pjesën e Llapit edhe të Gollakut dhe janë

24 identifikuar me ato brigadat tashti dhe me njësi. Po nuk e di

25 krejt saktë se nuk kemi pasë shumë lëvizje të mëdha neve.

1 Në pjesën e Gollakut prapë ka qenë brigada, kjo që ka
2 qenë, po një ndër ta ka qenë -- i kemi thënë "Guerilja".
3 Guerilja sepse është veprue në mënyrë guerile dhe në njerëz më
4 me pak në numër. Dhe për çdo aksion ka qenë për ata, është
5 quajttë guerilje, se nëse ka pasë nevojë për intervenime është
6 -- janë shkue numër i vogël i njerëzve.

7 Py. A e keni ditë ju ku ka qenë shtabi për zonën e Llapit, në
8 cilin vend në Llap?

9 Pë. Po, e kam ditë. Se ka lëvizë shtabi i zonës së Llapit. Ka
10 qenë në Lllapashticë, ka qenë në Majac. Dikur ma vonë ka kalu
11 dhe ka depërtue në Gollak. Kështu që nuk ka pasë ndonjë vend
12 që u stacionue aty dhe ka nejtë aty deri në përfundim të
13 luftës. Do të thotë ka pasë lëvizje.

14 Py. Po ju personalisht a ka ndodhë që të shkoni nga Barileva
15 në Lllapashticë apo Majac në shtab?

16 Pë. Po, kam shkue.

17 Py. A keni shku në cilësi të civilit apo ushtarit?

18 Pë. Jo, kam shku në cilësinë e ushtarit.

19 Py. Dhe cila ka qenë arsyeja që keni shku?

20 Pë. Arsyeja është shumë e -- ndoshta edhe është qesharake.

21 Sepse Salih Mustafa kaloi aty ke neve bashkë me Jusuf Shalakun
22 dhe këta e kanë pasë një automjet Golf II Fave, i cili
23 tërhiqte me të katër rrotat. Edhe neve na u dukej shumë
24 interesant se u bënë ushtri e fortë se e kemi këtë automjet.
25 Edhe prej kureshtje i kam lutë të më marrë, po jo me më marrë

1 shoqërues, po me më marr ta vozis unë. Edhe kanë qesh dhe më
2 kanë pranue vozits.

3 Py. A ka qenë i vetmi rast kur keni shku nga Barileva në
4 Llapashticë gjatë kësaj periudhe kohore?

5 Pë. Po, e vetmja.

6 Py. Po a --

7 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

8 Z. SHALA:

9 Py. Z. Dëshmitar, kur keni shku në shtab në atë kohë në cilin
10 vend ka qenë shtabi? Në cilin fshat?

11 Pë. Në Majac.

12 Py. Në Majac. E në Llapashticë a keni qenë?

13 Pë. Herë tjera, po.

14 Py. Sa larg është fshati Llapashticë prej fshatit Barilevë?

15 Pë. Nuk e di. Është problem me përshkru po është bukur shumë.

16 Është bukur shumë.

17 Py. Përafërsisht?

18 Pë. Me siguri i ka 13-14 kilometra ma shumë. Mund të ketë
19 edhe 20.

20 Z. SHALA: Znj. Kryetare, do të dëshiroja ta paraqisja
21 hartën e regjionit të Prishtinës, përkatësisht zonës së
22 Llapit, në të cilën paraqitet fshati Barilevë dhe fshati
23 Llapashticë. Llapashticë e Epërme.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
25 mund të vazhdoni.

1 Z. SHALA: Z. Oficer i Gjykatës, ju kisha lut që të
2 paraqitni dokumentin DSM00067, i cili dokument njëherë është
3 edhe dokumenti i bashkangjitur deklaratës, pjesa e parë të
4 dëshmitarit.

5 Py. Z. Dëshmitar, a jeni duke e pa hartën që është paraqit në
6 ekran?

7 Pë. Po.

8 Py. Shkrimi që është në pjesën e poshtme të kësaj harte dhe
9 data, a është shkrimi juaj?

10 Pë. Po.

11 Py. Këtu në hartë shifet një rrumbullak me numrin 1. Çka
12 paraqet?

13 Pë. Kjo paraqet fshatin Barilevë.

14 Py. Ndërkaq rrumbullaku tjetër më lartë ku e ka të shënuar
15 numrin 2?

16 Pë. E paraqet fshatin Lllapashticë e Epërme.

17 Py. Lllapashtica e Epërme, a është e njëjtë me Lllapashticën,
18 me fshatin Lllapashticë?

19 Pë. Kurrë nuk e kam ditë derisa e kam në hartë që këtu po
20 figuron Lllapashtica e Epërme. Kam mendu se krejt është e tëra.
21 Është një. Mirëpo sigurisht tek janë dy. Por nuk e di.

22 Py. Në këtë Lllapashticën e Epërme, a ka qenë shtabi i Zonës
23 Operative të Lllapit?

24 Pë. Po, ka qenë. Aty ka qenë Rustem Mustafa, komandant Remi
25 i vendosur me stafin e tij dhe oficerët përreth.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Avokat, po i afrohem orës 11.00. Desha t'jua tërheq vëmendjen
3 për këtë.

4 Z. SHALA: [Përkthim] Desha të mbaroja me këtë pjesë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
6 rregull.

7 Z. SHALA: E nderuara Kryetare, do të dëshiroja të
8 paraqitja edhe një dokument. Përsëri një hartë. Ku tani
9 paraqitet edhe fshati tjetër, që e përmendi dëshmitari, ku ka
10 qenë selia e shtabit të zonës operative.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
12 rregull. Mund të vazhdoni.

13 Z. SHALA: Faleminderit

14 I nderuari Oficer i Gjykatës, ju lutem paraqitni
15 dokumentin DSM00066.

16 Py. Z. Dëshmitar, a jeni duke e pa hartën në të cilën në
17 pjesën e lartë të saj janë të shkruar germet MAP dhe II romak?

18 Pë. Po.

19 Py. Në pjesën e poshtme është emri, mbiemri dhe nënshkrimi
20 edhe data. A është shkrimi juaj ky? A është nënshkrimi juaj?

21 Pë. Po.

22 Py. Pasi që pari na treguat që shtabi i Zonës Operative ka
23 lëviz nga fshati Llapashticë në fshatin Majac. Në këtë hartë,

24 a mund ta shifni ku gjindet fshati Majac? Dhe si është e

25 shënuar?

1 Pë. Po është e rrumbullakume me ngjyrë të kuqe dhe figuron
2 shkronja B.

3 Py. E a mund të na tregoni çka paraqesin këto rrumbullakë
4 tjerë të përcaktuara me numra, duke filluar nga numri 1 deri
5 në numrin 7?

6 Pë. Kjo duke fillu prej fshatit Barilevë, ku neve aty jemi.
7 Është fshati Vranidoll ky, është shumë afër, është numri 2.
8 Treshi është një fshat Rimanishtë, që nuk është shumë larg
9 tani Vranidollit. Ngjit me të është --

10 Py. Z. Dëshmitar?

11 Pë. Po.

12 Py. E përmendët fshatin Barilevë me numrin 1; fshatin
13 Vranidoll me numrin 2; dhe fshatin Rimanishtë --

14 Pë. Me numrin --

15 Py. -- me numrin 3. Tek këto dy-tri fshatra, a i përkasin të
16 njëjtit regjion? A i përkasin regjionit të Llapit apo i
17 përkasin regjionit të Gollakut?

18 Pë. Zyrtarisht me dokumentacion oficierie dhe kadastral i
19 përkasin njëjtë, mirëpo neve i kemi quajhtë dhe tani quhen, nga
20 dyshi ku është fshati Vranidoll e lartë, thuhet Gollak.

21 Pse thuhet nuk e kam idenë për atë punë, mirëpo në
22 regjistrat kadastral të gjithë këto janë pjesë e Prishtinës.

23 Py. Faleminderit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

25 Avokat, dëshmitari tha "i quajmë edhe tani i quajmë duke

1 filluar nga dyshi, nga Vranidolli dhe më lart i quajmë si
2 Gollak".

3 Dua që të di se çdo të thotë dëshmitari me këtë dhe "më
4 lart", kur thotë dhe "më lart".

5 Domethënë e ka për numrat që janë sipër dyshit, treshi e
6 tutje? E ka për hartën?

7 Z. SHALA:

8 Py. Z. Dëshmitar, kur e cekët që duke fillu nga Vranidolli
9 dhe Rimanishta dhe më lart i përket Gollakut. Çka keni menduar
10 me atë dhe "më lart"?

11 Pë. E kemi menduar sepse hin shumë fshatra në këtë kontest të
12 emrit ose të nofkës Gollak. Për shembull, sikur që është Llapi
13 me 70 fshatra. Ashtu është Gollaku. Nuk e di në numër. Mirëpo
14 është në numër bukur shumë fshatra. Por neve këto i kemi të
15 nënvijëzuara deri tek gjashta.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por
17 që ta kuptoj unë, Rimanishta është në Llap apo Gollak?

18 DËSHMITARI: Jo, është në këtë nofkën që neve e quajmë
19 edhe tani edhe quhet edhe ma herët quhet Gollak.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
21 nëse ju kuptova mirë ose mbase t'jua bëj si pyetje më mirë.
22 Majaci ku? Në ç'zonë është Majaci?

23 Pë. E kuptova. Është në zonën e Llapit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
25 të vazhdoni z. Avokat. Megjithëse, mbase është më mirë të mos

1 vazhdoni.

2 Z. SHALA: [Përkthim] Po. Mendoj se është momenti i duhur
3 për të bërë pushimin.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
5 rregull.

6 Z. Dëshmitar, tani do të bëjmë një pushim gjysëm ore,
7 deri në orën 11.00. Znj. Asistente e sallës do t'ju shoqërojë
8 të dilni nga salla, do të shihemi mbas gjysëm ore.
9 Faleminderit.

10 DËSHMITARI: Faleminderit edhe juve.

11 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Z. Avokat, keni përdorur një orë e 20 minuta do të
15 vazhdojmë mbas pushimit. Mund t'i thoni Trupit Gjykses edhe sa
16 kohë do t'ju duhet?

17 Z. SHALA: [Përkthim] Mbase 20 minuta.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 rregull.

20 Do të ndërpresim seancën tani dhe do të takohemi diçka
21 pas orës 11.30.

22 --- Pauza fillon në orën 11.03

23 --- Seanca rifillon në orën 11.31

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh
25 që përbërja e ekipeve është e njëjtë si më parë, e them për

1 procesverbal.

2 Mund të vazhdojmë me dëshmitarin. Znj. Asistente e sallës
3 -- jo, ka pyetje nga Avokati i mbrojtjes.

4 Z. SHALA: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, përpara se të
5 vazhdojmë me dëshmitarin, dua të përmend që në faqen 32,
6 rreshti 4 të transkriptit, ku dëshmitari përmend distancën
7 midis Barilevës dhe Llapashticës, siç e dëgjova unë
8 dëshmitarin ai nuk tha 30 a 40 kilometër, por tha 13 a 14
9 kilometër. Nëse nuk jemi të sigurt për këtë, do ta pyes
10 përsëri dëshmitarin ose mbase ta kontrollojnë përkthyesit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
12 propozoj që ta pyesni sërish. Unë, me thënë të drejtën, në
13 shënimet e mia kam shkruar 13 dhe 14, siç e thatë dhe ju. Por
14 mund ta bëni sërish këtë pyetje dhe pas kësaj gjithsesi ne
15 mund të vendosim nëse dëshirojmë të pyesim përkthyesit. Por,
16 le ta sqarojmë kështu.

17 Z. SHALA: [Përkthim] Faleminderit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Faleminderit, znj. Asistente e sallës.

20 [Dëshmitari vijon dëshminë]

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
22 se jeni rikthyer, z. Dëshmitar.

23 Do t'ia jap tani fjalën përsëri Avokatit të Mbrojtjes që
24 të vazhdojë me pyetjet e tij.

25 Z. Avokat, keni fjalën.

1 Z. SHALA:

2 Py. Z. Dëshmitar, më herët ju kam parashtruar një pyetje në
3 lidhje me distancën në mes të fshatit Barilevë dhe fshatit
4 Llapashticë. A ka mundësi edhe një herë të na tregoni, sa
5 është distanca në mes të këtyre dy fshatrave?

6 Pë. Znj. Kryetare e Gjyqit, është problem atë punë me e
7 përshkru po nuk qe gjeograf. Është problem sepse ne e kemi
8 frekuentuar atë rrugë por e keni frekuentuar natën, në kohëra
9 të vështira në shi, me baltë, me borë dhe na u ka duk shumë
10 larg. Tash po të më pyesësh kështu realisht, më duket se është
11 100 kilometër. Por në vijë, nuk e di saktë sa mund të jetë,
12 nuk mundet ta përshkruaj dot se mund të dal edhe qesharak edhe
13 jo mirë. Por diku duhet të ketë 10-15 kilometra me siguri.

14 Py. Faleminderit. Z. Dëshmitar, sot gjatë pjesës së parë në
15 faqen 31, rreshti 40, keni përmend Salih Mustafën i cili aty
16 ka kaluar së bashku me Isauf Shalakun.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
18 mund ta specifikoni kur thoni "aty", çfarë është?

19 Z. SHALA: [Përkthim] Duhet ta kontrolloj.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Thatë
21 "përmes aty".

22 Z. SHALA:

23 Py. A mund të na tregoni kur keni thënë "ka kaluar atje", për
24 ku keni menduar "ka kaluar atje"? Për cilin vend?

25 Pë. Po. Ka kaluar prej fshatit Vranidoll. Prej nga kanë ardh

1 nuk e di. Por është dashtë aty në fshatin Vranidoll edhe me
2 ardh në Barilevë. Tek lagja Vërrbovci.
3 Py. A ka qenë i vetmi rast kur e keni parë Salih Mustafën në
4 Barilevë?

5 Pë. Jo, ka qenë rasti i dytë, ky.

6 Py. A mund të na tregoni këto dy -- rastin e dytë edhe këtë
7 rast. Në cilën periudhe kohore ka ndodhë kjo? Në qoftë se ju
8 kujtohet?

9 Pë. Rasti i parë ka qenë shumë herët. Shumë herët, diku në
10 shkurt ose fillim marsi ose aty diku, por ka qenë borë. Rasti
11 i dytë ka qenë diku mesi i prillit. Mesi ose diku pak më larg
12 se mesi. Me datë nuk mund ta caktoj saktë, sepse është shumë
13 kohë e gjatë dhe nuk kam shënim.

14 Py. Mesi i prillit, cilit vit ju lutem? Mesi i prillit, i
15 cilit vit?

16 Pë. 1999.

17 Py. Faleminderit. A e dini arsyen pse ka qenë atë ditë Salih
18 Mustafa në Barilevë?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

20 Avokat, përpara se të kaloni tek pika tjetër, për mua
21 përgjigja e dëshmitarit nuk është e qartë kur thotë -- z.
22 Dëshmitar, mund t'i hiqni dëgjueset ju lutem, hiqini
23 dëgjueset. Faleminderit.

24 Jo, më mirë t'ju shoqërojnë të dilni nga salla.

25 Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin

1 të dalë nga salla.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Dëshmitari tha "pak më tej nga mesi i prillit", por mund të
5 jetë përpara ose mbrapa. Dhe ju kaluat në temën tjetër. Desha
6 ta sqaroj këtë.

7 Unë nuk dua që t'ju ndërhyj në pyetjet që do bëni, mund
8 ta bëj unë pyetjen, mund ta bëj dhe unë sigurisht pyetjen, por
9 dua që të ndërhyj sa më pak.

10 Znj. Asistente e sallës, ju lutem silleni sërish
11 dëshmitarin në sallë.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit z. Dëshmitar. Na u desh të diskutonim diçka
15 lidhur me një pyetje.

16 Z. Avokat, mund të vazhdoni.

17 Z. SHALA:

18 Py. Z. Dëshmitar, kur thua ka qenë diku në mes të prillit apo
19 pak më larg se mesi i prillit, çka mendon me atë "mesi i
20 prillit"?

21 Pë. Nuk mendoj ndonjë send të veçantë. Mirëpo, duke e
22 përshkruar 12 prillin dhe duke e kujtuar 22 prillin, aty dikur
23 ka qenë mesi i asaj periudhe. Sepse, pas 22 prillit më nuk
24 kemi qenë as neve aty. Dhe nuk kemi pas mundësi ma kontakti.

25 Se na u ka vështirësuar puna nga forcat e ushtrisë serbe, e na

1 u ka mbyll ai korridor. 12 prillin e dimë që kemi pas
2 ofensivën aty dhe kemi pas 2 viktima e një plagosje. Aty, do
3 të thotë që aty [e pakuptueshme] mend shumë bukur se janë
4 shumë të vështira edhe kështu që është problem me e përshkru
5 tash saktë ekzakt se cila datë, se kemi pas vështirësi shumë
6 të kalimit të njerëzve. Edhe nuk mund ta përshkruaj saktë.
7 Py. Pra ashtu siç deklaruat, si pikë referimi ju e merrni
8 datën 12 prill, ngjarja kur janë vrarë dy persona dhe datën 22
9 prill, si dita e fundit, ngjarja kur s'keni pas më mundësinë
10 lirisht të lëvizni.

11 Nga këto dy data, përafërsisht, cila është ajo ditë që
12 mundet me u përcaktu si ditë që e keni pa?

13 Pë. Është shumë e vështirë, sepse nuk e kam piketuar në
14 mendje se duhet ta mbaj mend. Aty është ajo esenca shumë e
15 fortë edhe nuk -- për neve ka qenë çdo moment, çdo -- vetëm
16 gjallë e shyqyr. Nuk u dite se do shpëtojmë e do mbajmë mend
17 diçka. Aty është ajo dobësia jonë ose ajo tani që jemi gjallë
18 fati jonë, ose nuk e di si ta quaj. Por nuk është -- ajo është
19 e keqe për ne pse ne s'kemi mbajt mend.

20 Py. Këtë herën e dytë, a e keni takuar ju personalisht Salih
21 Mustafën?

22 Pë. Po.

23 Py. A ju kujtohet në kohë, sa ka ndej në Barilevë atë ditë?

24 Pë. Po ka ndej bukur shumë sepse me atë makinën që përmenda
25 më herët me atë Faven [fonetike] e shoqërova edhe unë, por i

1 shoqërova si vozitës. Shkuam. Kur jemi kthyer, në kthim aty
2 kemi hëngër darkë së bashku në atë lagjen e Vërbovcve. Edhe
3 tani mua mu ka dasht, më kanë kërkuar tek rruga e lëvizjes së
4 njerëzve, e ky ka ngel aty me të tjerët ushtarët, njerëz.

5 Njerëz nuk kanë qenë në atë shtëpi, po kanë qenë aty
6 përreth edhe kanë qenë shumë, që është dash neve me i kalu.

7 Py. A ju kujtohet, pasi që jeni kthyer, cilin drejtim ka
8 marrë Salih Mustafa, ku ka shku?

9 Pë. Na e ka thënë Jusufi se do të shkojë për Zllash

10 Py. A ju kujtohet arsyeja pse ka pas të shkojë në Zllash?

11 Pë. Jo. Arsye s'kemi pas nevojë ta dimë dhe ka qenë e
12 pakuptimtë edhe me i pyet, "Pse po shkon e për ç'a po shkon".
13 Sepse ata shumicën e kohës andej diku kanë ndejt, jo te neve.

14 Z. SHALA: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, dua t'i tregoj
15 dëshmitarit dëshminë e tij që ia ka dhënë Mbrojtjes, pjesa 1,
16 datë 22 mars 2021, për t'ia rifreskuar kujtesën.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
18 kuptova. Mund të vazhdoni.

19 Z. SHALA: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. SHALA: Z. Oficer, ju lutem paraqitni dokumentin
21 DSM00056 deri në 00067 në gjuhën angleze. Dhe dokumentin
22 DSM00716-00726 në gjuhën shqipe. Faqen 6 të dokumentit në të
23 dyja gjuhët.

24 Py. Z. Dëshmitar, në deklaratën që e keni dhënë më 22 mars të
25 vitit 2021 Avokatit Mbrojtës, në pyetjen e Avokatit "Pse ju

1 desh të shkonte në Zllash", duke menduar për Salih Mustafën,
2 ju keni dhënë përgjigjen:

3 "Dikush e thirri atë në telefon, me telefon satelitor, se
4 në atë zonë kishte numër të madh të plagosurish kështu që ai u
5 largua për atje me nguti".

6 A ju kujtohet që e keni dhënë këtë deklaratë?

7 Pë. Po.

8 Py. A ju kujtohet se kështu ka ndodh atë ditë?

9 Pë. Po.

10 Py. A mund të na tregoni edhe njëherë pse Salih Mustafa me
11 ngut u dasht të niset rrugës për në Zllash, atë ditë?

12 Pë. Po se kur deshën të nisen, unë u takova me Jusufin: "Pse
13 Jusuf po ikni kaq shpejt"? Tha, "Se e thirrën Calin. Paska
14 shumë të plagosur". Thashë, "Po vij edhe unë me juve". Tha,
15 "Jo, nuk mund të vish krejt se është vështirë edhe këtu po
16 ngelim keq". Thashë, "Jo se po kam qejf", me atë dëshirën e
17 madhe, prap po e them, për me shku me ta dhe me vozitë atë
18 automjet. Kam shkuar deri tek një fshat diku aty të Gollakut.
19 Këta kanë vazhduar tutje, unë jam kthyer me një traktor me të
20 tjerë ushtarë, prap për në Barilevë.

21 Py. Faleminderit. Po ashtu në kohën kur i keni dhënë
22 deklaratën Avokatit Mbrojtjes në pyetjen e Avokatit, sa kohë
23 ishte kjo para 22 prillit, ju jeni përgjigj:

24 "Ndoshta 4 ose 5 ditë para 22 prillit të vitit 1999".

25 A ju kujtohet që e keni deklaruar këtë?

1 Pë. Po. E saktë është ashtu. Sepse më 12 prill edhe më 22
2 prill, po del aty diku 4 këndeje ose 4 andej, po del aty diku
3 në mes.

4 Py. Faleminderit. A e dini ju, apo keni dëgjuar që Salih
5 Mustafa ka qenë edhe ndonjëherë tjetër në fshatin Barilevë në
6 periudhën kohore nga 24 marsi i vitit 1999, e deri në ditën
7 kur për herë të fundit e keni takuar në muajin prill të vitit
8 1999? Dhe a ka qëndruar edhe për me fjet aty?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] T'i
10 marrim pyetjet me radhë, nga një pyetje me radhë.

11 DËSHMITARI: A mund të përgjigjem?

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
13 mund të përgjigjeni.

14 DËSHMITARI: Me siguri se ka kaluar. Por, për me e dit unë
15 se ka kaluar, atëherë kur jam takuar me Jusufin, ka qenë pak
16 më e lehtë me e kuptu se a ka qenë ky ose nuk ka qenë. Sepse
17 Jusufi ka qenë ai i cili na ka orientuar, ai i cili na ka
18 mbajt aty. Edhe për atë tani është, nëse ka ardh vetëm hera të
19 tjera ka mundësi që unë mos me e taku. Nuk ka qenë e thënë dhe
20 nuk ka qenë e domosdoshme për t'i takuar të gjithë.

21 Pë. Faleminderit, z. Dëshmitar.

22 Z. SHALA: [Përkthim] [flet anglisht]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
24 mund të këshilloheni me bashkëavokatin.

25 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

1 Z. SHALA:

2 Py. Z. Dëshmitar, a keni dëgjuar ndonjëherë për njësitin të
3 quajtur BIA?

4 Pë. Po, kam dëgjuar.

5 Py. A mund të na tregoni kur për herë të parë keni dëgjuar?

6 Pë. Kur ekzakt nuk mund ta përshkruaj, por kemi dëgjuar se ai
7 njësit është formuar pas vrasjeve të 3 dëshmorëve, tani
8 dëshmorë shumë heronj të mëdhenj shumë shqiptarë të mirë, ka
9 qenë Iliri, Bahriu dhe Agroni. Edhe për ata e ka marrë këtë
10 emër.

11 Py. Ju, a keni qenë pjesëtar i këtij njësiti?

12 Pë. Zyrtarisht dhe me dokumentacion, nuk e di. Neve
13 gjeografikisht, gjeografikisht e them në atë kuptimin që,
14 gjeografikisht kemi qenë pak më larg Prishtinës dhe nuk jemi
15 marrë shumë kush me ku është. Neve kemi ndihmuar, kemi
16 vepruar, kemi kontribuar në Brigadën 151, që nuk i kemi takuar
17 asaj brigade. Kemi qenë ushtri vullnetare, bile neve si njësit
18 kemi qenë më tepër humanitar se vullnetar. Edhe nuk e --
19 thjesht tani mund të them kemi qenë ky ose kemi qenë ai, por
20 nuk -- diçka krejt zyrtare tani në fund është që kemi qenë
21 pjesë e gueriljes e kemi dit të gjithë, por atyre njësive të
22 vogla qysh janë quajtur, e kemi kuptuar mbasi ka mbaruar
23 lufta.

24 Py. Në kohën kur e keni takuar Salih Mustafën, a e keni dit
25 çfarë pozite ka pas Salih Mustafa? Pozitë ushtarake?

1 Pë. E kemi dit se ka qenë Jusuf Shalaku përgjegjësi i jonë, e
2 ky ka qenë përgjegjësi i Jusuf Shalakit.

3 Py. A e ke dit se cilit njësit i ka takuar Salih Mustafa, në
4 atë kohë po flas për muajin mars-prill të vitit 1999?

5 Pë. E kuptoj. E kemi dit se është edhe ky një prej
6 përgjegjësve të gueriljes. Por a ka qenë komplet i gueriljes,
7 apo ka qenë i një njësie tjetër, ose ka qenë së bashku me
8 Jusufin, nuk e di.

9 Py. Gjatë periudhës së luftës, duke e llogarit nga muaji
10 janar i vitit 1999 deri në muajin qershor të vitit 1999, a
11 keni qenë në ndonjë njësi tjetër përveç njësitit vullnetar që
12 e përmendët këtu?

13 Pë. Jo, nuk kam qenë.

14 Py. Ju kujtohet pas luftës, me çfarë aktiviteti jeni marrë?
15 Po flas për periudhën qershor 1999 deri në qershor të vitit
16 2000.

17 Pë. Unë edhe para luftës kam punuar në fabrikën e
18 amortizatorëve.

19 Py. Jo. Pyetja ishte pas luftës.

20 Pë. Po, po. E kuptova pyetjen. Mirëpo kjo është tuj ndërlihd.
21 Aty në atë fabrikë ku kam punuar më herët para lufte deri në
22 [e pakuptueshme] kur jam larguar dhe prapë pas përfundimit të
23 luftës, do të thotë si ka mbërrit përfundimi i luftës 12
24 qershor, mos them krejt më 12 qershor por aty diku më 16 apo
25 20, jemi kthyer në jetën në fabrikë. Puna nuk ka pas shumë,

1 por jemi kthyer aty për me e rikuperuar vendin e punës dhe
2 fabrikën.

3 Py. Po gjatë vitit 1999, a keni punuar edhe në polici?

4 Pë. Jo.

5 Py. Faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
7 të vazhdoni.

8 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

9 Z. SHALA:

10 Py. Z. Dëshmitar, më herët gjatë deklaramit ju e përmendët
11 një veturë të markës Golf 4x4. A e dini pronar i këtij
12 automjeti kush ka qenë?

13 Pë. Ka qenë Jusuf Shalaku, i ndjeri Cufa.

14 Py. A ju kujtohet, për aq herë sa e keni pa Salih Mustafën
15 kur vinte në Barilevë, a ju kujtohet si ka ardh aty? A ka ardh
16 me ndonjë mjet apo?

17 Pë. Nëpërmjet [e pakuptueshme] me automjet.

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
20 keni fjalën.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Më falni që ju ndërpres, por
22 mua nuk më duket se është konstatuar me saktësi për të cilat
23 herë të tjera e ka fjalën Avokati i Mbrojtjes.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Hiqini dëgjueset z. Dëshmitar, ju lutem.

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Më duket se dëgjuam që u takua,
2 e pa Salih Mustafën një herë më përpara?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dy
4 herë. Unë e kuptoj se për çfarë e keni fjalën. E kam një
5 pyetje, por unë e kisha rezervuar si pyetje të Trupit Gjykses
6 për të mos e ndërprerë. Por ju e bëtë këtë pyetje dhe ju
7 falënderoj për këtë. Nëse mund të përcaktoni se për shembull
8 nëse ka qenë dy herë, për ato dy herë që e ka takuar ta
9 përcaktojë, mbase për të tretën mund të jetë më e
10 përgjithshme. Por për ato dy herë mund të ketë më shumë
11 dijeni.

12 Është e pranueshme kjo znj. Prokurore?

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për sa kohë është e qartë se
14 për cilën herë bëhet fjalë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Avokat keni fjalën.

17 Z. SHALA: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. SHALA:

19 Py. Z. Dëshmitar, ato dy herë kur e keni takuar Salih
20 Mustafën, përkatësisht kohën kur ka ardh në fshatin e
21 Barilevës, a ju kujtohet në çfarë forme ka ardh aty? A ka ardh
22 me ndonjë mjet transportues, apo?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
24 Avokat, pyetja është e qartë, s'ka nevojë më tej, mund të vij
25 përgjigja.

1 DËSHMITARI: Për herën e parë nuk e di se si ka ardh.

2 Herën e dytë ka ardh me atë Golf-in së bashku me Jusufin. Edhe
3 për atë e mbaj mend pak më shumë se mu dha rasti me e vozit
4 vetë. Edhe është njëfarë ndjenje që nuk kisha vozitë
5 ndonjëherë makinë të atillë.

6 Pë. A të kujtohet kur kanë ardh së bashku me Jusufin, ti
7 personalisht a i ke pyet nga ku kanë ardh?

8 Py. Jo, nuk i kam pyet. E vetmja pyetje ka qenë, "A keni mund
9 me ardh mirë" edhe "A keni ardh shëndoshë". Ajo ka qenë
10 gjithçka.

11 Pë. Faleminderit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
13 lutem përdorni mikrofonin dhe koha thujse ju ka përfunduar.

14 Z. SHALA: [Përkthim] Vetëm një minutë. Faleminderit.

15 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

16 Z. SHALA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, faleminderit
17 shumë. S'kemi më pyetje për këtë dëshmitar.

18 Z. SHALA:

19 Py. Z. Dëshmitar, faleminderit shumë. Unë nuk kam më pyetje
20 për juve.

21 Pë. Mirë. Faleminderit edhe prej juve. Trupit Gjykses
22 faleminderit shumë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
24 do të shikojmë se si do të vijojmë. Znj. Prokurore, unë
25 propozoj siç kemi vepruar deri tani çdo ditë, mund të bëjmë

1 tani pushimin. Është ora 12.00. Dhe mund ta bëjmë për një orë
2 e gjysmë. Dhe pastaj mund të vazhdojmë me kohën që na ka
3 mbetur duke marrë parasysh që po e përfundojmë më herët
4 seancën e paradites. Ose mund të vazhdojmë edhe tani.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Unë do
6 të përfitoja nga mundësia e pushimit të drekës në mënyrë që të
7 organizoj referencat.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
9 mirë.

10 Z. Dëshmitar, tani do të bëjmë një pushim një orë e
11 gjysmë. Pas kësaj do të vazhdojë dëshmia e juaj me pyetjet që
12 do t'jua bëj Zyra e Prokurorit të Specializuar, në rregull?

13 Pra, do t'i kërkoj Asistentes së sallës që t'ju shoqërojë
14 të dilni nga salla, do të shihemi pas një ore e gjysmë.

15 DËSHMITARI: Mirë. Faleminderit.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit.

19 Seanca ndërpritet këtu deri në orën 13.35.

20 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.08

21 --- Seanca rifillon në orën 13.33

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
23 mirë. Të shohim sa i takon të pranishmëve. Të gjitha ekipet
24 janë me të njëjtën përbërje, për procesverbalin.

25 Do të vijojmë tani me kundrapyetjet që do t'i bëjë Zyra e

1 Prokurorit të Specializuar.

2 Prisni pak përpara se të fusim dëshmitarin në sallë. Nuk
3 e di, ka diçka për të thënë, se shikoj disa lëvizje në të
4 majtën time.

5 Keni fjalën z. Shala.

6 Z. SHALA: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.
7 Desha të përfitoj nga rasti që të sqaroj diçka lidhur me
8 përgjigjen e dhënë nga dëshmitari, në faqen 25, rreshtat 11
9 deri në 16.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
11 Prisni pak, faqja 25 thatë.

12 Z. SHALA: [Përkthim] Jo, faqja 42.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duhet
14 që ta korrigjojmë edhe këtë në transkript. Faqja 42, rreshtat
15 11 deri në 16. Po. Ja sa ta nxjerr në ekran.

16 Z. SHALA: [Përkthim] Po, e përmendi fshatin në Gollak.
17 Desha të sqaroj emrin e fshatit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Emrin.

20 Z. SHALA: [Përkthim] Dhe në këtë kuptim të përdorim
21 hartën.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e
23 shoh tani. Faqja 42, rreshti 11 dhe 16 dhe mund ta lexoj:

24 "Kur deshën të largohen u takova me Jusufin e pyeta 'Pse
25 po largoheni me kaq nxitim'".

1 Për këtë e keni?

2 "Dhe ai tha, 'Po, e kanë thirrur Saliun... Do të vijë me
3 ju... Jo, jo është e vështirë' dhe unë i thashë që ta ngrahja
4 përsëri atë veturë, kështu që vajta në një fshat në Gollak.
5 Vazhduan më tej, ndërsa unë u ktheva në Barilevë".

6 Ju doni të dini se për cilin fshat e kishte fjalën "Një
7 fshat në Gollak".

8 Z. SHALA: [Përkthim] Po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Dëgjova që thatë që dëshironi t'i tregoni hartën? Unë propozoj
11 që të fillojmë me këtë, ta pyesim se për cilin fshat e kishte
12 fjalën. Dhe pastaj nëse është e nevojshme mund t'i tregoni
13 hartën.

14 Shumë mirë. Znj. Prokurore, ju do ta filloni pak më
15 vonë.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Sigurisht, pa problem nga ana
17 jonë, e nderuar Gjykatëse.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
19 mirë.

20 Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin
21 të hyjë në sallë.

22 [Dëshmitari vijon dëshminë]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
24 lëshoj dhe një urdhër gojarisht lidhur me materialet të cilat
25 ZPS-ja synon t'i përdorë gjatë pyetjeve të veta.

1 Mirë se u rikthyet z. Dëshmitar. Shpresoj që pushimi të
2 ketë qenë i mirë.

3 DËSHMITARI: Faleminderit, mirë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
5 mirë. Në rregull. Do të vijojmë me kundrapyetjet e Zyrës së
6 Prokurorit të Specializuar. Por përpara kësaj, Avokati i
7 Mbrojtjes dëshiron që të sqarojë diçka lidhur me një prej
8 përgjigjeve që ju dhatë sot paradite përpara pushimit. Kështu
9 që fillimisht fjalën do t'ia jap Avokatit të Mbrojtjes.

10 Keni fjalën.

11 Z. SHALA: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

12 Py. Z. Dëshmitar, sot pas pyetjes së Mbrojtjes në faqen 42 të
13 transkriptit, rreshti 11 dhe 16, keni deklaruar ndër të tjera
14 se, "Unë kam shkuar gjer lart në një fshat të Gollakut".

15 A të kujtohet deri në cilin fshat në regjionin e Gollakut
16 keni shkuar atë ditë?

17 Pë. Po, më kujtohet.

18 Py. Cili është ai fshat?

19 Pë. Duhet të jetë Radashec.

20 Py. Nga Barileva deri në Radashec, nëpër sa fshatra keni
21 kaluar?

22 Pë. Diku, duke mos e përfshirë Barilevën, duhet të jetë katër
23 ose pesë. Katër gjithsesi

24 Py. Faleminderit.

25 Z. SHALA: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, mund t'ia

1 tregoj hartën për të parë se prej cilët fshatra kanë kaluar?

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
3 mund të vazhdoni.

4 Z. SHALA: [Përkthim] Faleminderit shumë.

5 Z. SHALA: Z. Zyrtar i Gjykatës, nëse keni mundësi
6 paraqiteni dokumentin me numër DSM00066.

7 Py. Dëshmitar, a është paraqit një hartë në ekranin e juaj?

8 Pë. Po e shoh dhe është e qartë.

9 Py. A mund të na tregoni në hartë duke filluar nga Barileva
10 dhe duke përfunduar në Radashec, emrat e të gjitha fshatrave
11 që keni kaluar atë ditë?

12 Pë. Po. Me numër 1 është e rrethuar dhe numër 1 fillojmë nga
13 Barileva. E rrethuar dhe numri 2 është fshati Vranidoll. E
14 rrethuar dhe numri 3 është Rimanishtë. E rrethuar dhe me
15 numër 4 është fshati Sharban. E rrethuar dhe me numër 5 është
16 Siqevë, e cila për momentin nuk m'u kujtua por tani e shoh
17 këtu. Dhe është e rrumbullakosur me numrin 6 Radashec.

18 Py. A ju kujtohet sa ka zgjat rruga nga Barileva deri në
19 Radashec?

20 Pë. Ka zgjat shumë, sepse ka qenë shumë llaç, ka qenë shi
21 edhe me shumë vështirësi. Diku shumë herë kemi ngel në llaç
22 edhe e kemi shty makinën, por prap kemi ecur. Por, orë nuk kam
23 pasur, që me e dit saktë në sa ora u nisem edhe në sa
24 përfunduar aty. Nuk e di. Por shumë kemi ecur dhe shumë jemi
25 lodhur. Kështu që me kohë nuk guxoj ta bashkoj se nuk e di.

1 Py. Faleminderit, z. Dëshmitar.

2 Z. SHALA: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, faleminderit
3 shumë. Nuk kam më pyetje të tjera. Dua vetëm të di për kohën
4 që do të përdorë Prokuroria për pyetjet që do t'ia bëjnë
5 dëshmitarit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit z. Avokat i Mbrojtjes.

8 Kemi lëshuar një urdhër gojarisht, siç mund t'ju
9 kujtohet, kemi vendosur në mes të dhjetorit të vitit që shkoi
10 më datë 13 më ekzaktësisht, që kundrapyetjet parimisht nuk
11 duhet të zgjasin më shumë se pyetjet që i bën pala thirrëse.
12 Por kjo nuk cenon të drejtën e palës që bën kundrapyetjet për
13 të kërkuar kohë shtesë nëse është e nevojshme dhe nëse japin
14 justifikimin e duhur.

15 Është mjaft e hapur, por duhet të jetë brenda arsyes. Nuk
16 e di nëse iu përgjigja. Shoh që po pohoni me kokë.
17 Faleminderit. Shumë mirë.

18 Znj. Prokurore, përpara se t'ju jap fjalën më duhet që të
19 lëshoj një urdhër gojarisht, që edhe të keni mundësi të vijoni
20 me kundra pyetjet.

21 ZPS-ja i ka kërkuar leje Trupit Gjykses përmes emalit të
22 datës 4 prill 2022, në orën 9.27 në mëngjes, për të nxjerrë
23 tre materiale të tjera shtesë t'i përdori në kundrapyetjet e
24 Dëshmitarit 700. Ky material është nxjerr më mbrapa në orën
25 8.48 [sipas përkthimit].

1 Trupi Gjykues vëren që materialet e nxjerra rishtazi janë
2 të kufizuara në gjatësi dhe në objekt, disa janë prej burimeve
3 të hapura që janë mbledhur kohët e fundit ose janë zbuluar
4 ditët e fundit nga ZPS-ja në përgatitjet që ka bërë për
5 kundrapyetet për dëshmitarin numër 700.

6 Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja ka treguar arsye të
7 vlefshme për mos nxjerrjen e materialeve paraprakisht. Trupi
8 Gjykues gjithashtu vëren se Mbrojtja nuk ka kundërshtim për
9 përdorimin e këtyre materialeve nga ZPS-ja.

10 Trupi Gjykues autorizon fillimisht ZPS-në që të përdorë
11 materialet e nxjerra rishtazi në kundra pyetjet që do t'ia bëj
12 Dëshmitarit në përputhje me paragrafin 31 të Urdhrit për
13 Zhvillimit e Procesit.

14 Znj. Prokurore, mund të vazhdoni me kundra pyetjet tuaja.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
16 Gjykatës.

17 Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli:
18 Py. Mirëdita z. Nreci. Unë jam përfaqësuese e Prokurorisë e
19 cila do të drejtojë pyetjet sot pasdreke.

20 Në përgjithësi është diçka që ua themi të gjithë
21 dëshmitarëve. Kohën e kemi të kufizuar për secilën palë,
22 prandaj ju lutem të dëgjoni me vëmendje pyetjet dhe përgjigjet
23 t'i jepni vetëm për sa i përket pyetjes, pa hyrë shumë në
24 hollësi. Nëse ka nevojë pastaj për ndonjë sqarim apo për të
25 shtuar ndonjë informacion, jua kërkoj unë. Nëse do të shikoj

1 që do t'ju shmangeni në përgjigje pyetjes, do t'ju kërkoj
2 pastaj shprehimisht që të fokusoheni të përqendroheni tek
3 pyetja.

4 Në rregull?

5 Pë. Në rregull. Faleminderit.

6 Py. Në rregull. Z. Nreci, kemi folur sot për data në veçanti,
7 data të ngjarjeve që kanë ndodhur përpara më shumë se 20
8 vitesh, përpara më shumë se 23 vitesh.

9 Lidhur me këtë, por edhe duke pasur parasysh disa pyetje
10 të disa datave të ngatërruara gjatë pyetjeve, a do të ishte e
11 drejtë nëse do të thoshim që, mund t'i ngatërroni datat e
12 ngjarjeve që janë kaq larg në kohë, pavarësisht që mund të
13 përpiqeni që të jeni preciz, i saktë. Pra, a është e mundshme
14 që mund t'i ngatërroni datat?

15 Pë. Është e mundshme, sepse janë mbi 23 vite. Jo me dashje,
16 jo më qellim, po pa ndonjë të keqe munden me u ngatërru shumë
17 lehtë. Se nuk kemi ndonjë interes për t'i ngatërruar. Ne kemi
18 interes për t'i zgjidhur, jo për t'i ngatërruar.

19 Py. Patjetër, sigurisht. Kjo ka ndodhur në fakt me deklaratën
20 e parë të cilën ju ia keni dhënë Avokatit të Mbrojtjes, siç e
21 dëgjuam edhe sot gjatë pyetjeve që Mbrojtja jua bëri.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do të jap referencat për Trupin
23 Gjykses. Është në faqen 15 të transkriptit, rreshtat 20-21.

24 Py. Kur ju thatë, z. Dëshmitar që, "I kam ngatërruar datat,
25 më pas i kam korigjuar dhe kam thënë që është 12 prilli dhe

1 jo 22 prilli”.

2 Pastaj në faqen 18 të transkriptit, rreshtat 24 dhe 25 ku
3 keni thënë:

4 “Ka kaluar shumë kohë. Siç e thashë kam ngatërruar 22
5 prillin me 12 prillin”.

6 Ju kujtohet kjo?

7 Pë. Po, më kujtohet.

8 Py. Në rregull. Pra për ta përmbledhur, në deklaratën e parë
9 që i keni dhënë Avokatit Mbrojtës ju thatë që ju kujtohet se
10 vdekja e këtyre dy personave z. Kurti dhe z. Kaçiu, ka ndodhur
11 më 22 prill, por në fakt kanë vdekur më datë 12 prill, kështu?

12 Pë. Ekzakt ashtu është.

13 Py. Dhe në fakt ka qenë ekipi i Mbrojtjes ata të cilët e kanë
14 korigjuar deklaratën tuaj, kështu?

15 Pë. Po.

16 Py. Nuk është se e korigjuat ju vetë, pra ti vetë?

17 Pë. Jo. Ne e korigjuam përmes shokëve dhe fshatit aty, se e
18 kam ba një lapsus po pa ndonjë qëllim, pa i lënduar edhe
19 familjarët. Edhe familjarët tashti janë ndjerë të ofenduar.
20 Por jo me ndonjë qëllim të keq, jo me ndonjë diçka tjetër. Ka
21 qenë ngatërrim, 12, 22. Në vend që me qenë 1 përpara atij 2-
22 it, ka dalë 2. Nuk e kuptoj por jo me ndonjë qëllim, diçka që
23 e rendën dikë.

24 Py. Sigurisht. Pyetja ishte kjo, ishte Avokati i Mbrojtjes ai
25 që ta tregoi që ishte gabim. Nuk është se e kuptove ti vetë që

1 ishte gabim. Nuk është se e kuptove ti vetë që ishte gabim, pa
2 e kuptuar Avokati i Mbrojtjes, kështu?

3 Pë. Po, po. Avokati e kish kuptuar edhe e dokumentoi dhe e
4 argumentoi me fotografi.

5 Py. Në rregull. Gjatë pyetjeve që jua bëri Avokati i
6 Mbrojtjes sot, thatë se ti vetë nuk kishe ndonjë arsye apo
7 ndonjë shpjegim për këtë.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Është në faqen 23 të
9 transkriptit, në rreshtat 5 deri në 6.

10 Py. A ju kujtohet?

11 Pë. Po.

12 Py. Në rreshtat 2 deri në 3 të të njëjtës faqe 23, keni
13 thënë:

14 "Viktima kishim përditë dhe këta të dy janë vrarë në
15 ditën kur na kanë sulmuar".

16 A të kujtohet?

17 Pë. Po, gjithsesi.

18 Py. Unë jam në dijeni që ka shumë ofensiva, ofensiva të mëdha
19 e të vogla nga serbët gjatë asaj periudhës, periudhës mars-
20 prill '99. A nuk është kështu?

21 Pë. Po, po ashtu. Se nuk kanë qenë të gjitha të llojit të
22 njëjtë.

23 Py. Po, mos është kjo një prej arsyeve që e bën të vështirë
24 përcaktimin e datës, që të kujtosh datat gjatë asaj periudhe
25 kohore, flas për mars-prill të vitit '99?

1 Pë. Po e ban. Sepse, ti nëse në dasmë me shku diçka harron e
2 shkon në dasmë për urim dhe për zbavitje, e jo në luftë. Në
3 luftë është tmerr i botës e ku ta mbash mendjen në çdo gjë.

4 Py. Po. Në fakt këtë shpjegim e jep edhe në deklaratën e dytë
5 që ia ke dhënë Mbrojtjes, ajo që mban datën 19 prill 2021, me
6 numër DSM00068, faqen 3. Dhe aty thua, përgjigjja jote është:

7 "Po, e kuptoj".

8 Po lexoj nga deklarata:

9 "Asokohe kishte çdo ditë ofensiva të vogla serbe, prandaj
10 dhe i ngatërroj datat".

11 Të kujtohet që e ke thënë kështu?

12 Pë. Po, po.

13 Py. Në rregull. Do të kaloj tani tek herët kur je takuar me
14 Salih Mustafën në Barilevë në vitin '99. Do të bëj një
15 përmbledhje të atyre që janë thënë sot paradite, pastaj do
16 vazhdojmë me pyetjet.

17 Dëshmove këtu sot se hera e parë kur e ke parë Salih
18 Mustafën, po flasim për vitin 1999, ka qenë shkurt-mars '99 se
19 kishte ende borë. Është në faqen 38, rreshtat 14 deri 15, të
20 transkriptit *live*. A të kujtohet që the kështu?

21 Pë. Po.

22 Py. Rasti i dytë ka qenë në prill të vitit '99 dhe the që po
23 përpiqem ta vendos në kohë midis datës 12 dhe 22 prill. Është
24 nën faqen 39 të transkriptit, rreshtat 22-23.

25 A të kujtohet që the kështu?

1 Pë. Po.

2 Py. Dhe dëshmove gjithashtu se të kujtohet mirë kjo kohë
3 sepse i ke grah veturës me Jusuf Shalaku dhe Salih Mustafën.
4 Është në faqen 40 dhe 41. Është kështu?

5 Pë. Po.

6 Py. Gjithashtu the në faqen 41, rreshti 8, që z. Shalaku dhe
7 z. Mustafa po shkonin për Zllash, në gjysmën e dytë të këtij
8 udhëtimit.

9 Pë. Po.

10 Py. Pra, përmende, dhe po flas tani për faqen 42 dhe 43, që
11 ti vazhdove me ata deri në një fshat diku në Gollak, të cilin
12 tani e mësuam që është Radasheci, kështu?

13 Pë. Po.

14 Py. Kështu që ti nuk vazhdove me ata dhe the se u ktheve në
15 Barilevë me traktor, faqen 42, rreshtat 11 deri 16, ndërsa ata
16 vazhduan për në Zllash. A nuk është kështu?

17 Pë. Ekzakt kështu është.

18 Py. Pra, fshati që sapo mësuam ku u ndatë ishte Radasheci.
19 Dhe aty u ndatë dhe ata vazhduan për në Zllash. Kështu?

20 Pë. Po.

21 Py. Sa i takon kohës së këtij udhëtimit, na the që nuk mundesh
22 me e përshkru me saktësi se kur ka ndodhur - është në faqen 40
23 të transkriptit, në fillim në rreshtin 4 dhe 5, pastaj në
24 rreshtin 12 deri 13 - dhe se nuk të kujtohet data e saktë e
25 këtij udhëtimit. Kështu?

1 Pë. Jo, me datë ekzakt nuk mund të piketoj se ka qenë kjo
2 datë ose ajo.

3 Py. Pra, a nuk do të kisha të drejtë të thosha që, thjesht
4 mund ta thuash me përafërsi se kur ka ndodhur takimi në fjalë
5 dhe udhëtimi, për të cilin po flasim, midis datës 12 dhe 22
6 prill. Nuk do të ishte e saktë nëse do të thosha kështu?

7 Pë. Jo, është shumë e saktë se në mes 12 dhe 22, po. Por në
8 mes të 12 dhe 22 janë disa ditë të cilat nuk guxoj, jam nën
9 betim, me thanë shembull ta marrin diku, po është kjo. Më
10 ekzakt nuk e di.

11 Py. Po, është e qartë. Avokati i Mbrojtjes të rikujtoi atë që
12 i kishe thënë Avokatit Mbrojtës në deklaratën e parë që u ke
13 dhënë atyre, ku ti thua se ky udhëtim - dhe e kam fjalën këtu
14 për faqen 6 të deklaratës së Mbrojtjes së datës 22 mars 2021.
15 Në faqen 6, ti ke thënë:

16 "Ky udhëtim ka ndodhur mbase 4 a 5 ditë para 22 prillit
17 të vitit '99".

18 Të kujtohet që ke thënë kështu?

19 Pë. Po, e kam thanë.

20 Py. Pastaj, në deklaratën e dytë që ia ke dhënë Mbrojtjes të
21 datës 19 prill 2021, kur Avokati të ka kërkuar të sqarosh apo
22 të shpjegosh këtë ngatërrimin e datave, të datës 12 me datën
23 22 prill, në lidhje me të njëjtin udhëtim me Z. Mustafa, ti
24 thua dhe këtu po citoj nga faqja 5 e dokumentit me numër
25 DSM00068 deri në 00075. Aty të thotë avokati:

1 "A të kujtohen këto pyetjet dhe përgjigjet e intervistës
2 sonë"?

3 Ti i thua:

4 "Po, disa ditë para 22 prillit. Është e saktë".

5 A të kujtohet që ke thënë kështu?

6 Pë. Po.

7 Py. Në fakt ti the që nuk mund të jesh i saktë. Por nga njëra
8 anë kemi këtu një përgjigje 4 deri në 5 ditë, nga ana tjetër
9 kemi disa ditë.

10 A nuk do ishte e drejtë nëse do të thoshim që në fakt nuk
11 mund të thuash me saktësi se ka qenë një, dy, tri a pesë ditë
12 përpara 22 prillit?

13 Pë. Nuk mundem sepse është edhe 12 që na kujton shumë gjëra,
14 është edhe 22 që na kujton. Dhe prandaj mund të themi 4, ose
15 5, ose aty diku. Edhe mbi 12 prillin, por edhe aty diku para
16 22 prillit.

17 Py. Pra, nuk mund ta thuash me saktësi se kur ka ndodhur.
18 Këtë e kuptojmë. Por, nga ana tjetër e kuptoj që nuk mund të
19 thuash më saktësi se sa ditë përpara 22 prillit ka ndodhur,
20 apo jo?

21 Pë. Znj. Prokurore, nuk mundem se ti e pe pak më herët, datat
22 e të vdekurve janë vra për të njëjtën ditë, në të njëjtin
23 minutë dhe kanë tani në gurët e tyre në përmendoret e tyre, ka
24 ndryshime. Prandaj ka qenë shumë katrahurë e fortë dhe nuk e
25 besoj se është...

1 Py. Më fal, z. Dëshmitar. Pyetja që të bëra ishte, nuk mund
2 të thuash se sa ditë përpara 22-shit ndodhi ai udhëtimi me z.
3 Mustafa. Këtë doja të thosha. Është e saktë kjo? Mund t'i
4 përgjigjesh kësaj pyetje që të bëra.

5 Pë. Po, të kuptova. Po nuk -- me datë që të them 13, 14, ose
6 19, ose 21, ose 22, nuk mund ta përcaktoj datën që të them që,
7 po ka qenë kjo datë ekzakte edhe jemi aty.

8 Py. Në rregull. E kam të qartë tani.

9 Tani, për sa i takon rolit që kishte z. Shalaku dhe z.
10 Mustafa, këtu dua të sqaroj disa nga ato që the përpara.

11 Ti na the sot se - dhe kjo është në faqen 44, rreshti 14
12 - se ti e dije se Jusuf Shalaku ishte përgjegjës i grupit
13 tuaj, i njësisë tuaj, kështu ka qenë?

14 Pë. Po.

15 Py. Dhe se e dije - i ke thënë në të njëjtat faqe - se Salih
16 Mustafa ishte personi mbi Jusuf Shalakun, pra eprori të themi
17 i këtij, kështu është?

18 Pë. Po.

19 Py. Sot në mëngjes na the - dhe kjo është në faqen 9, rreshti
20 14 - se Jusuf Shalaku ishte përgjegjësi juaj, kështu ka qenë?
21 Komandanti.

22 Pë. Po.

23 Py. Po z. Salih Mustafa, e quaje gjithashtu si eprorin tënd?

24 Pë. Jo, Salih Mustafën e quante Jusufi epror. Neve nuk kemi
25 pas asnjë kontakt asnjë urdhër nga ai, asnjëherë. I kemi marrë

1 dhe i kemi dorëzuar tek Jusufi, jo urdhrat por sugjerimet i
2 kemi marrë gjithherë nga Jusufi dhe i kemi transportu tek
3 Jusufi.

4 Py. E kuptoj. Por po të ndjekim logjikën, meqë Jusufi ishte
5 komandanti jot dhe Sali Mustafa ishte komandanti i Jusufit, i
6 bie që të ishte edhe përgjegjësi i yt, apo eprori yt. Kështu?

7 Pë. Po. Me siguri se po.

8 Py. Me siguri apo ishte?

9 Pë. Po, ishte.

10 Py. Në rregull. Doja ta sqaroja se në fakt këtë ke thënë në
11 dëshminë që i ke dhënë Mbrojtjes. Kjo kishte të bënte me
12 pyetjen që të bënë, pse për çfarë qëllimi qëndroi në Barilevë
13 Salih Mustafa. Dhe këtë e citoj nga faqja 6 e deklaratës së
14 dhënë në 22 mars, me numër DSM00056 deri në 00067. Dhe
15 përgjigjen po e lexoj këtu për të sqaruar këtë pikën e eprorit
16 dhe vartësit:

17 "Sepse ai ishte eprori ynë dhe ne ishim vartësit e tij".

18 Kështu ke thënë. E mban mend që e ke thënë këtë fjali?

19 Pë. Për Jusufin, po. Për Salihun nuk më kujtohet, ndoshta ka
20 mundësi. Po që se është aty e shkruar duhet të jetë ashtu. Po
21 kur ka qenë epror i Jusufit, duhet me qenë edhe i joni. Dhe
22 respektimi ka qenë çdo herë.

23 Py. Unë po të lexoja atë që ke thënë në një prej përgjigjeve
24 të tua, kur të ka bërë pyetje Avokati i Mbrojtjes. Ato që unë
25 lexova, ishin fjalët e tua. Po të duash mund të ta tregojmë

1 edhe në deklaratë, ta tregojmë në ekran. Por unë vetëm citova
2 ato fjalë që ke thënë ti lidhur me Salih Mustafën. Ke thënë,
3 "Ai ishte eprori ynë dhe ne ishim vartësit e tij".

4 A të freskohet kujtesa me këto që po të them për fjalët
5 që ke thënë gjatë intervistës?

6 Pë. Po, më kujtohet. Po kjo atëherë në atë kohë tek Avokati
7 Mbrojtës ka pas një konotacion pak më të gjerë. Tani është
8 shumë shkurt dhe po, pasi që -- prapë e them me shumë
9 përgjegjësi, pasi që Jusuf Shalaku ka qenë përgjegjësi i jonë.
10 Jusufit i është dash me pas diku një përgjegjës. Për atë e
11 kemi respektuar Jusufin, respektojmë dhe të tjerët edhe i kemi
12 respektuar të gjithë.

13 Py. Po të pyes edhe njëherë, veten e ke quajt si vartës të
14 Salih Mustafës?

15 Pë. Jo.

16 Py. Atëherë ta shohim mbase--.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Më mirë të shohim deklaratën,
18 që të shohë tekstin.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
20 Dëshmitar, do t'i kërkoj Asistentes së sallës që t'ju
21 shoqërojë për të dalë nga salla. Pastaj do t'ju kthejmë
22 përsëri. Faleminderit.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuara Gjykatëse, duket se
3 Prokurorja po përpiqet të krijojë idenë e varësisë së
4 drejtpërdrejtë, një marrëdhënie të drejtpërdrejtë komande.
5 Por, mënyra se si bëhet pyetja është shumë e përgjithshme
6 lidhur me atë që ka qenë. Sepse z. Shehu mund të ishte
7 komandant dhe mund të mendojë se edhe ai ishte vartës i dikujt
8 apo i çdo personi që mund të kishte një post në radhët e UÇK-
9 së.

10 Dua thjesht të sigurohem që, a ka një njësi të
11 drejtpërdrejtë e cila varet drejtpërdrejtë nga Salih Mustafa,
12 apo Salih Mustafa ka një pozitë të cilën ai e përmend si
13 komandant dhe ai vetë duke qenë në një pozitë më të ulët, jo
14 në të njëjtën pozitë, i bie të jetë vartës, në këtë kuadër.

15 Po përpiqem të them këtë, që Prokuroria duhet të ketë
16 parasysh që nuk flasim në përgjithësi, por flasim
17 drejtpërdrejtë për këtë komandë dhe çështjen e komandës dhe të
18 vartësit.

19 Nuk e di nëse e shpjegova qartë, por kam atë ndjesinë që
20 njësia e z. Mustafa, BIA të themi, dhe njësia e dëshmitarit në
21 Barilevë cilado që të ishte emri, kishin ndonjë lidhje me
22 njëra tjetrën?

23 Në këtë drejtim është me rëndësi të përcaktohet dhe të
24 vërtetohet se cila ka qenë apo nëse dëshmitari di gjë për
25 lidhjen midis njësisë se tij dhe njësisë apo pozicionit që

1 kishte z. Mustafa.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 [mikrofoni çaktivizuar].

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Apo thjesht që Jusufi është
5 eprori juaj dhe ai i raporton z. Mustafës, dhe i bie që ti je
6 vartës. Nuk janë në të njëjtën njësi. Prandaj kjo gjë duhet
7 vërtetuar, të paktën përpara se sa të flasim në termat e
8 përgjithshme, se ka qenë komandant dhe jo të themi që, a mund
9 të themi këtë, a mund të themi atë. Janë pyetje të mbyllura
10 për të cilat jepet përgjigja.

11 Shpresoj që ta kem bërë të qartë atë që dua ta them dhe
12 që Prokuroria të kuptojë këtë që unë dua të them.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
14 shpreh edhe unë mendimin, por së pari dua të dëgjoj atë që ka
15 për të thënë Prokurorja.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit. Nuk pajtohem,
17 sepse unë e pyeta dëshmitarin për fjalët që ka thënë vetë. Ai
18 tha lidhur me z. Mustafa se e konsideronte eprorin e tyre dhe
19 se ata ishin vartësit.

20 Edhe sot shtoi tjetër lidhje midis Jusufit dhe Z. Mustafa
21 përveç përshkrimit të njësitit ku mund të ketë shërbyer z.
22 Nreci. Nuk është dhe shumë e qartë sepse sot na tha që ishte
23 anëtar i njësisë guerilje dhe tha që pas lufte, e tha dhe në
24 deklaratë, se ata ishin pjesë e gueriljes, ishin guerilas. Dhe
25 tha se ishin pjesë e Brigadës 153. Ne e dimë që BIA ka

1 ekzistuar që në '98 dhe Brigada 153 u formua më vonë në shkurt
2 '99. Doja ta eksploroja edhe këtë temë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Mendoj që nuk është shumë e përgjithshme pyetja. Siç tha znj.
5 Prokurore, ajo hëpërhë po përdor pjesë të dëshmisë së këtij
6 dëshmitari të dhënë si përpara Gjykatës edhe përpara Avokatit
7 të vet Mbrojtës, ku përmend marrëdhënien midis komandantit dhe
8 vartësve. Jo vetëm ato që tha znj. Prokurore sipas fjalëve të
9 tij që, "ai ishte eprori dhe ne ishim vartësit", por edhe në
10 përgjigje të pyetjes se "përse qëndroi në Barilevë Salih
11 Mustafa"?

12 Ai tha që:

13 "Ai ishte kryetar i gueriljes dhe shumica e personave që
14 ishin në Barilevë, i takonin gueriljes".

15 Në faqen 6 ai thotë:

16 "Si të mos takohesh me komandantin".

17 Për momentin nuk mendoj se znj. Prokurore po e kalon
18 cakun e pyetjeve që duhet të bëj. Duhet të vazhdojmë për
19 momentin.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] A mund të them edhe diçka?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
22 duhet të vazhdojmë tani.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

25 Dëshmitar, më dëgjon?

1 DËSHMITARI: Po.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
3 vazhdojmë me pyetje. Znj. Prokurore keni fjalën.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

5 Py. Z. Dëshmitar, një minutë sa të gjej ku e lamë dhe t'i
6 kthehem përsëri pyetjes që të bëra.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ndërkohë kërkova që të vendosin
8 deklaratën. Nuk e di nëse e kanë vënë në ekran. DSM00056 deri
9 në 00067. Faqen 6, ju lutem në fillim.

10 Py. Z. Nreci, a mund të komentoni pak...

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të kalojmë pak më poshtë tek
12 kjo faqe këtu. Kjo është faqja 5, faqja më përpara. Në fund të
13 faqes. Faleminderit.

14 Py. Z. Nreci, unë pak përpara të lexova nga përgjigja që ti i
15 ke dhënë Avokatit të Mbrojtjes. Po ta lexoj përsëri pyetjen
16 dhe përgjigjen që ti ke dhënë.

17 "Përse Salih Mustafa qëndroi në Barilevë"?

18 Dhe ti je përgjigjur:

19 "Sepse ai ishte eprori ynë dhe ne ishim vartësit e tij.

20 Ai shkonte në Lllapashticë apo në Majac, sikurse shkonte dhe
21 tek baza e Remit, domethënë komandanti Rustem Mustafa që ishte
22 komandanti, dhe kur kthehej kalonte nga Barileva".

23 Dua të kuptoj se, pse tani the jo kur të pyeta: E

24 konsideron Salih Mustafën si eprorin tënd?

25 Më shpjego. Unë lexova nga ato që ti ke thënë. Ti ke

1 thënë që e shihnim si eprorin tonë dhe "ne ishim vartësit e
2 tij". A të kujtohet kjo?

3 Pë. Po, tani është pyetja shumë e qartë. Se neve komandant
4 kryesor kemi pas Rustem Mustafën. Dhe ka pas edhe komandantë
5 të tjerë. Mirëpo neve personalisht si njësit dhe unë
6 personalisht, përgjegjësi dhe llogari i kemi dhënë Jusuf
7 Shalakut. Për atë e thashë atë "jo". Se ky ka mund me qenë në
8 Prishtinë ose në pjesën e Gollakut, edhe ne tani të ngelemi
9 ose të kuptohemi me komandantin -- për atë e thashë atë, "jo".
10 Nuk e thashë atë "jo" që e urrej, a nuk e kam dashtë apo diçka
11 tjetër. Po "jo" me kuptimin e fjalës se ka qenë Jusufi ai që
12 ka qenë afër nesh. Kjo është ajo, "jo".

13 Py. E kuptoj që Jusuf Shalakun e konsideroj si eprorin tënd,
14 për të përdorur fjalën tënde. Por pyetja që të bëra unë kishte
15 të bënte me z. Salih Mustafën. Sepse përpara ti i ke thënë
16 Mbrojtjes se "ishte eprori ynë dhe ne ishim vartësit e tij".

17 Pse tani po thua që nuk ishte eprori yt? Nuk e kam fjalën
18 për eprorin e menjëhershëm, të drejtpërdrejtë që the.

19 Pë. Tani të kuptoj drejtë. Epror e kemi pas padyshim edhe nuk
20 e kam mohuar atë as në luftë, as pas lufte, as para Avokatit,
21 as tani. Por me atë kuptimin që epror pak më të afërt edhe për
22 me i dhanë llogari shpejt e shpejt edhe për me marrë
23 instruksionet ka qenë ai. Jo me ndonjë kuptim që po du me e fy
24 atë se nuk e njoh për komandant. Jo, nuk është ashtu. E kemi
25 respektuar, e respektojmë dhe e respektojmë tanë jetën.

1 Py. E kuptoj. Ta shoh nëse e kuptova si duhet. Komandanti i
2 drejtpërdrejtë ishte Jusuf Shalaku, ai që ishte më afër.

3 Kështu?

4 Pë. Po.

5 Py. Në rregull. Po Salih Mustafa, a ishte edhe ai gjithashtu
6 një nga eprorët e tu? M'u përgjigj po ose jo, të lutem.

7 Pë. Po, pas Jusufit. Se është e pamundshme Jusufin me e
8 respektue e atë mos me e respektue.

9 Py. Në rregull. E kuptoj. Faleminderit që e sqarove.

10 Tani dua që shpjegimin tënd, apo konfirmimin tënd për një
11 pjesë tjetër të deklaratës.

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Është e njëjta deklaratë që
13 kishim, por tani të kalojmë në fund të faqes 4.

14 Py. Këtu të kanë pyetur, të pyeti Avokati i Mbrojtjes. Po ta
15 lexoj pyetjen dhe përgjigjen tënde të plotë.

16 "Si e ke njohur z. Salih Mustafa"?

17 Kjo është pyetja që të ka bërë Avokati i Mbrojtjes.

18 Dhe ti je përgjigjur:

19 "Jam njoftuar me të përmes një shoku tim me të cilin
20 kisha punuar më parë. Kjo ka qenë në fillim të vitit '98. Që
21 nga aty e tutje ne iu bashkuam radhëve të UÇK-së ndërsa UÇK-ja
22 po zgjerohej. Pastaj ishim në kontakt me të pasi ai ishte kreu
23 i gueriljes dhe shumica e ushtarëve të UÇK-së në Barilevë i
24 përkisnin gueriljes".

25 A e pohon që e ke thënë këtë?

1 Pë. E pohoj se këtë e thashë edhe më herët para Mbrojtjes.

2 Py. Në rregull. Pra, pajtohemi këtu.

3 Pë. Po.

4 Py. Meqë po flasim për vitin '98 lidhur me rolin që ti ke
5 pas. Me sa kuptoj je kyçur në UÇK në '98, kështu?

6 Pë. Po, në verën '98. Ose në pranverën e vonë.

7 Py. Dhe nga '98 deri në '99, ke pas ndonjë gradë, ndonjë
8 pozitë?

9 Pë. Jo. Gradat, pozitat, emërimet, janë ba qysh vonë krejt.
10 Nuk e kam të qartë saktë kur edhe si janë ba, por janë ba
11 shumë vonë. Pak para përfundimit të luftës.

12 Py. Në rregull. Ke qenë ushtar, ushtar i thjeshtë pa ndonjë
13 gradë, kështu?

14 Pë. Po.

15 Py. Në rregull. Lidhur me rolin dhe detyrat që ke pas. Në
16 faqen 44, sot në rreshtat 9 deri në 11 të transkriptit, ke
17 thënë, e dije se ishe pjesë e njësisë gueriles dhe se këtë e
18 ke kuptuar pas lufte. E mban mend që the kështu?

19 Pë. Po, e kam thanë kështu. Se kemi qenë saktë e asaj pjese,
20 zyrtarisht e kemi kuptuar mbas lufte. Por edhe para lufte e
21 kemi dit se jemi anëtarë të gueriljes. Por se krejt qysh ka
22 vepruar guerilja, nuk kemi dit se s'kemi pas ndonjë mundësi të
23 shpjegimit më gjatë të dikujt për këtë gjë.

24 Py. Po vetë ti, a e konsideroje veten pjesë të gueriljes, siç
25 na the vetë?

1 Pë. Po. Po çdo herë. Sepse aty kanë operuar edhe brigadat
2 edhe njësi të ndryshme, jo me rroba, jo me njerëz të ndryshëm,
3 jo me armatim të ndryshëm. Por në një farë forme neve guerilja
4 është dashtë me vepru me numër ma të vogël të njerëzve.

5 Py. E kuptoj. E di ti kur u krijua Brigada 153?

6 Pë. Jo. Më vjen keq, por nuk e di.

7 Py. Nuk ke nevojë të kërkosh ndjesë. Po BIA, a e di kur është
8 formuar?

9 Pë. Jo. As BIA kur është formuar saktë nuk e di. E di që kemi
10 qenë në guerilje, por kur është formuar BIA, nuk e di. Atë
11 emër dhe atë nofkë që neve e kemi thënë, e kemi kuptuar fare
12 vonë.

13 Py. Në rregull. Por nga ato që lexuam në deklaratën tënde në
14 faqen 4, kuptoj se ti e dije që kur u kyçe në UÇK ishe pjesë e
15 një njësie, në kohën që UÇK-ja po zgjerohej. Ti, ishe pjesë e
16 kësaj njësisë që edhe kjo po zgjerohej në territorin ku ishit?
17 Po ose jo, m'u përgjigj.

18 Pë. Po.

19 Py. Në rregull. T'i përmbledh detyrat siç na the në mëngjes
20 dhe unë po e përmbledh atë që the ti nga faqja 10 e
21 transkriptit se, detyra kryesore që kishit ishin të ndihmonin
22 popullsinë në lëvizje, të vëzhgonin lëvizjet e armikut, të
23 ndihmonin me ushqime dhe me gjëra të tjera.

24 I përmbledha ato që ke thënë në faqen 10, rreshti 14 deri
25 në 25 të transkriptit.

1 A e përmblodha mirë këtë që ke thënë për detyrat tuaja?

2 Pë. Po.

3 Py. Në rregull.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

5 Prokurore, keni pyetje tjetër për këtë? Se ju cituat atë që

6 ishte në transkript, apo e kam gabim?

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, por doja të sigurohesha që

8 këto ishin detyrat që na përshkroi dëshmitari.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sepse

10 nuk dëgjova që të bënit pyetje, kishit ndonjë detyrë tjetër

11 apo e ke thënë?

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund ta pyes?

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo.

14 Në qoftë se e bëni vetëm përmbledhje, e pamë dhe në rastin e

15 Avokatit Mbrojtës. Sepse s'ka kuptim vetëm ta përmbledhësh,

16 këtë e lexojmë vetë.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po. Po përpiqesha të kuptoja më

18 mirë rolin e dëshmitarit.

19 Py. Përveç detyrave që unë të përmenda, kishte gjera të tjera

20 që bënit ju?

21 Pë. Gjëra me rëndësi, jo. Me rëndësi të veçantë që do të

22 thotë këtë ose atë, jo. Përveç se ato çka ju i përmbledhët.

23 Py. Në rregull. Faleminderit.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Një minutë sa të konsultohem.

25 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

2 Gjykatës. Deri në orën 3.00 e kemi këtë sesion?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

4 Faleminderit që më kujtuat që ta vendos programin se është e

5 rëndësishme për të gjithë ne.

6 Do e bëjmë sesionin normal, 1 orë e gjysmë. Kemi filluar

7 në orën 13.30 kështu që do të vazhdojmë deri në orën 15.00.

8 Pastaj do të bëjmë pushim 15 minuta dhe do të vazhdojmë deri

9 në orën 16.00.

10 Nesër pastaj kemi 4 sesione.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar

12 Gjykatëse. Mund të them se mund të mbaroj para pushimit, deri

13 në orën 15.00.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

15 mirë. Faleminderit. Mund të vazhdoni.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

17 Py. Z. Dëshmitar, dua të kaloj tani tek një pjesë tjetër.

18 Desha të të pyes, a je shok me Brahim Mehmetaj, ndryshe

19 i njohur me emrin Bimi?

20 Pë. Shok me "po" ose "jo" është vështirë me e përmbledh, por

21 e njoh.

22 Py. E njeh. Por, a e konsideron shok?

23 Pë. Nuk kemi diçka të keqe, po me u taku, takohemi shumë

24 rrallë, shoku i punëve të tjera. Kur i thua shok, duhet të

25 shkosh ta vizitosh shpesh dhe të pish kafe pothuajse çdo ditë.

1 Atë gjë nuk e mbaj mend kur e kemi ba.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

3 Prokurore, mund ta pyesni dhe ndryshe se është -- hytë në
4 pikën konkrete. Por mund ta kishit pyetur: a e njeh apo s'e
5 njeh. Pra duhet t'i linit njëfarë hapësire dëshmitarit.

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit për sugjerimin.

7 Py. Z. Dëshmitar, nëse mund të pyes, si e njeh z. Mehmetaj,
8 nga e njeh?

9 Pë. E njoh mbas lufte. E ka pas një restorant që ne i themi
10 Pallati i Rinisë në Prishtinë. Dhe aty kemi shku kemi pi kafe,
11 kemi ndejt edhe me fëmijët edhe me shokë të tjerë. Kështu që
12 me e njoh, e njoh nga aty. Para përfundimit të luftës, nuk e
13 kam njoh, se s'e kam pa kurrë.

14 Py. Pra nuk e ke njoh gjatë luftës, kështu?

15 Pë. Po, nuk e kam njohur.

16 Py. Tani dua të të tregoj disa postime të Facebook-ut nga
17 llogaria e z. Mehmetaj, nga faqja e z. Mehmetaj.

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem nxirrni në ekran ERN
19 SPOE00325341.

20 PY. Ne ndërkohë sa të dalë kjo z. Dëshmitar, dua të të pyes,
21 a të kujtohet nëse i ke komentuar ndonjë postim në Facebook z.
22 Mehmetaj pak para se të transferohej, të vinte në Hage z.
23 Mustafa?

24 Është një postim në të cilin ti ke komentuar. Është e
25 datës 26 shtator 2020. Të kujtohet ky postim?

1 Pë. Si fotografimin e shoh. Me Facebook-un jam shumë dobët. Ka
2 mundësi që edhe e kam postuar, ka mundësi e kam shti nipin me
3 shkru. Por tashti ta shoh se nuk e di ekzakt, shumë seriozisht
4 nuk e di që e kam -- se nuk postoj për askënd.

5 Py. Pa problem. Do ta nxjerr komentin për të cilin desha të
6 pyes.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Këtë fotografi mund ta heqim.
8 Nëse mund të nxjerrim në ekran dokumentin me numër
9 SPOE003325348. Ngjitur me të përkthimi në anglisht,
10 SPOE00325348-ET.

11 Ju lutem ta zmadhojmë komentin e katërt.

12 Py. Z. Nreci, a e sheh komentin tënd në të djathtë të
13 ekranit, ajo që është në shqip. Është komenti i katërt me rend
14 nga fillimi.

15 Pë. Po.

16 Py. Në koment thuhet:

17 "Respekt i përjetshëm për çlirimtarët dhe familjet e
18 tyre".

19 A është komenti yt ky? A i pohon këto fjalë, apo jo?

20 Pë. Unë e shoh emrin tim dhe e shoh shkrimin. Por, edhe nëse
21 nuk është, shumë e pëlqej dhe e pranoj. Sepse duhet të kemi
22 respekt tërë jetën për çlirimtarët, pikë së pari, e dyta është
23 për NATO-n. Nuk kam diçka tjetër. Dhe kjo nuk është ndonjë që
24 me -- E paskam shkruar, më vjen mirë që e paskam shkruar, për
25 respekt për çlirimtarët. Nuk kam cekë emra, znj. Prokurore,

1 nuk ka cek ndonjë emër Bislimi apo dikush tjetër. Por, respekt
2 për çlirimtarët dhe prap them publikisht, shumë respekt për
3 çlirimtarët.

4 Py. Po, e kuptoj nga deklarata dhe nga dëshmia që dhe këtu
5 sot se Salih Mustafën e njeh që prej vitit '98, kështu?

6 Pë. Si emër Sali Mustafa e njoh nga larg shumë moti. Por tani
7 fizikisht e kam njof nga '98 e këndeje. Por për me e pa, me e
8 prek, me fol me të, është kur ka ardh në Barilevë.

9 Py. Kur në vitin '98?

10 Pë. Diku në pranverën e vonë, ose fillimi i verës. E di që
11 kemi qenë në majica të shkurtra, jo me rroba të trasha. Do të
12 thotë që ka qenë pranvera e vonë ose fillimi i verës, aty
13 diku.

14 Py. Kjo ka qenë e vetmja herë kur e ke takuar në vitin '98,
15 apo jo?

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
17 Prokurore, unë do të sugjeroj më pak orientuese, që të mos
18 përmbajë përgjigjen.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po nga që është në deklaratë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E di,
21 por provoni mos ta vendosni përgjigjen gati.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

23 Py. Z. Dëshmitar, do ta ndryshoj pyetjen, do ta them ndryshe.

24 Kjo ka qenë e vetmja herë që je takuar me Salih Mustafën në
25 '98, apo ka pasur edhe herë të tjera gjatë atij viti?

1 Pë. Ekzakt nuk e di që jemi takuar ndonjëherë me ndonjë
2 kështu. Por atëherë kur jemi takuar, jemi takuar me Salih
3 Mustafën dhe Jusuf Shalakun për organizimin, për rrjedhën qysh
4 mund të jetë lufta po na afrohet. Edhe kështu që ajo ka qenë
5 biseda edhe takimi. Takimi ka qenë i atij lloji. Se duhet të
6 organizohemi, duhet të mobilizohemi dhe të presim luftën. Por
7 ka qenë shumë takim i shkurtër se unë kam qenë ai që nuk kam
8 pas kohë.

9 Py. Po. A i ke ruajtur, ke mbajtur kontakte me z. Mustafa pas
10 luftës?

11 Pë. Po. Jo të shpeshta. Jo ku me e dit sa shpesh, sepse vetë
12 jeta vetë obligimet e jetës mbas lufte na kanë nda dhe nuk
13 kemi mundur me u taku. Nuk kemi qenë të lirë prej punës, prej
14 halleve dertëve të familjes. Dhe kështu që nuk kemi pas takime
15 të shpeshta.

16 Py. Ju kuptoj. Nëse mund ta përcaktosh kur thua "jo shpesh",
17 sa herë sa shpesh pak a shumë, nëse mund ta thuash je takuar
18 me të?

19 Pë. Ka mundësi me muaj me gjysmë viti, ka pas herë edhe që
20 nuk jemi takuar. Se unë jetoj në Barilevë, është diku 15
21 kilometra nga Prishtina. Prandaj dhe obligimet e fshatit nuk
22 kam pas ndonjë. Për me dalë në Prishtinë duhet me pas edhe një
23 arsye tjetër edhe me u taku me ndonjë shok aty pari shpejt e
24 shpejt, edhe me u kthj në fshat.

25 Py. Kuptoj. Po mbas arrestimit të tij, a je vendos në kontakt

1 me të, e ke kontaktuar?

2 Pë. Jo.

3 Py. Po me ndonjë anëtar të familjes së Z. Salih Mustafa ke
4 qenë në kontakt, mbas arrestit të tij?

5 Pë. Po, kam qenë me vëllain e tij, Arbenin.

6 Py. Me ç'rast, nëse mund të na e thuash? Dhe kur ka ndodhur?

7 Pë. Kur tash saktë, prapë këtë datën nuk e mbaj mend. Mirëpo
8 në një pikë karburanti u takuam dhe pyeta çfarë ka nga ju. Tha
9 avokati është në Prishtinë dhe disa të dhëna për dikë që e
10 njeh për dikë që e din ku ka qenë, që është takuar dikush me
11 të, është duke i mbledhë. Thashë, një prej tyre, nëse mund të
12 kontribuoj, jam edhe unë. Kështu që të nesërmen më kanë thirr,
13 jemi takuar. Të nesërmen ose të pasnesërmen, ka pas ndonjë
14 dite kështu, por nuk e di ekzakt një ditë, dy, tri. Dhe kam
15 shkuar, jemi takuar me të edhe me avokatin, i cili është këtu.

16 Py. Pra z. Arben Mustafa ishte personi që të vendosi në
17 kontakt në lidhje me ekipin e Mbrojtjes së Salih Mustafës?

18 Pë. Po.

19 Py. Po, në rregull. Z. Nazmi Verbovci, a e njeh?

20 Pë. Po. Patjetër se po.

21 Py. Nga e njeh?

22 Pë. E njoh sepse është i Barilevës. Por e njoh dhe respektoj
23 babën e tij se na e ka liruar shtëpinë. Qysh me vërejtjen e
24 parë të lëvizjeve, na e ka liruar shtëpinë ka thënë, kjo
25 shtëpi është e juaja. Se ka pas edhe shtëpia të tjera, kështu

Dëshmitari: Bislim Nreci (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 88

1 që ka pas një shtëpi të boshatisur. Kështu që e kemi përdorur
2 neve ushtarët për me ndej, për me hongër, me pushu, me fjet.
3 Për atë e njoh. E njoh edhe djalin e tij Nazmi, i cili ka qenë
4 ushtar.

5 Py. E kuptoj saktë nëse them që edhe Nazmi Verbovci ka qenë
6 në UÇK? Kështu?

7 Pë. Po.

8 Py. Çfarë roli luante ai, nëse e di?

9 Pë. Ai luante rolin e ushtarit edhe mbasi ishte aty i asaj
10 lagjeje, luante rolin e koordinatorit për tu transferuar
11 popullata dhe njerëzit pa dallim të asaj ane, me u kalu nga
12 Gollaku në Barilevë dhe prej Barilevës në Gollak. Ka luajtur
13 rolin e koordinatorit të atij veprimi, të asaj pune.

14 Py. Ishte dhe ai anëtar i gueriljes si ti?

15 Pë. Po.

16 Py. A di gjë nëse edhe komandanti i tij ishte Jusuf Shalaku
17 si ti?

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
19 Prokurore, mund ta kishe bërë pyetjen: a di kush është
20 komandanti i tij.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po. Mund ta ndryshoj, e nderuar
22 Gjykatëse.

23 Py. A e di kush ishte komandanti i tij?

24 Pë. Po, po. Ishte Jusufi, se Jusufi ka qenë i të njëzetëve
25 aty që kemi qenë.

Dëshmitari: Bislim Nreci (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 89

1 Py. Në rregull. Z. Nreci, a ke ndjekur ndonjë prej seancave
2 gjyqësore të këtij procesi gjyqësor këtu, gjatë këtyre javëve
3 të fundit apo muajve të fundit?

4 Pë. Jam mundu me i ndjek. Por të gjitha nuk kam pas mundësi,
5 shkakut i punëve dhe i angazhimeve të shtëpisë. Nuk kam mundur
6 të gjitha.

7 Py. Të kujtohet se cilët dëshmitar ke ndjekë, ke përcjellë?

8 Pë. Për zotën pjesën e parë kur ka qenë ai Fatmir, mbiemri
9 nuk më kujtohet. Njërin prej tyre Fatmir. Edhe kështu nuk e
10 di.

11 Py. Mos e ke fjalën për z. Fatmir Humollin?

12 Pë. Po, po. Edhe të tjera, ka pas ndonjë sekuencë aty këtu,
13 ose në lajme sa ka qit televizori. Se saktë, me i ndjek nuk
14 kam pas shumë kohë.

15 Py. Mirë.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam tani
17 disa pyetje të cilat kanë të bëjnë me hollësi personale të
18 dëshmitarit që nuk duhen diskutuar në publik. Ju kërkoj që të
19 kalojmë në seancë private.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit.

22 Z. Sekretar, ju lutem të kalojmë në seancë private.

23 [Seancë private]

24 [Seancë private teksti i fshirë]

25

Dëshmitari: Bislime Nreçi (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 90

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Nreci (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 91

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Nreci (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 92

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Nreci (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 93

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Nreci (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 94

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Nreci (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 95

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislam Nreci (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 96

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Nreçi (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 97

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Nreçi (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 98

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislum Nreci (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 99

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Nreci (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 100

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21 [Seancë e hapur]

22 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të hapur.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Znj. Prokurore, vazhdoni.

Dëshmitari: Bislim Nreci (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 101

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

2 Py. Z. Nreci, ju falënderoj që ju përgjigje pyetjeve që të
3 bëra. Nuk kam pyetje të tjera nga ana jonë. Faleminderit.

4 Pë. Faleminderit edhe juve.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
6 do të bëjmë 15 minuta pushim dhe do të vazhdojmë deri në orën
7 16.00 dhe do të shikojmë se kur do të mbarojmë. Nesër është
8 ditë e re.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] A mund të rri në këtë pushim të
10 shkurtër z. Mustafa të qëndrojë këtu?

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
12 pyes oficerët e sigurisë.

13 Po, dakord.

14 Z. Dëshmitar, punonjësja e gjykatës do të të nxjerri
15 përjashta. Kemi 15 minuta pushim dhe do të punojmë deri në
16 orën 16.00

17 DËSHMITARI: Mirë, faleminderit.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Atëherë do të rifillojmë në 15.25.

22 Këtu mbyllet seanca.

23 --- Pauza fillon në orën 15.10

24 --- Seanca rifillon në orën 15.25

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

1 se keni ardhur z. Ndreçi.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 DËSHMITARI: Faleminderit. Mirë se ju gjej.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
5 do t'ia jap fjalën Mbrojtëses së Viktimave për pyetjet nëse
6 ka.

7 Keni fjalën Mbrojtësja e Viktimave.

8 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës.

9 Po do të doja të pyesja për dy aspekte që nuk besoj të marrin
10 shumë kohë.

11 Pyetje nga Mbrojtësja e Viktimave:

12 Py. Mirëdita z. Dëshmitar. Unë jam Mbrojtësja e Viktimave dhe
13 dua që t'ju bëj nja dy pyetje për disa gjëra të cilat nuk i
14 kam dhe shumë të qarta ende.

15 Dua që të kthehemi tek data kur z. Kurti dhe z. Kaçiu ka
16 vdekur.

17 Nga sa na shpjeguat sot, kuptova që fotografitë e gurëve
18 të varreve të ndihmuan - që pamë më përpara këtu në ekran - ta
19 freskuar kujtesën. Dhe në këtë kontekst dua të di nëse e di ti
20 si familjeve iu dhanë ato datat që janë të shënuara në gurët e
21 varrit? Nga i morën familjet ato data?

22 Pë. Po aty janë konë të ditme sepse ka qenë 12 prilli ka qenë
23 ofensiva që ka qenë aty. Dhe u dit se ata në mbromje vdiqën.

24 Ata kishin vdekë gjatë kohës kur erdhën forcat serbe dhe
25 familjarët nuk janë konë larg tyre. Ata menjëherë e kuptuan se

1 të afërmit e tyre nuk i kanë.

2 Prandaj është datë që edhe nuk harrohet edhe mbahet mend
3 edhe prej familjarëve po edhe prej shokëve të tyre, miqve,
4 farefisit.

5 Py. Në rregull. Faleminderit për përgjigjen. Por ti vetë na
6 shpjegove se në fillim mendove se ishte 22 prill dhe më vonë e
7 lidhe me 12-n? Si e mban mend ti që ishte data 12 dhe jo 11 e
8 prillit duke pasur parasysh këto dy gurët e varreve që i pamë
9 më herët? Dhe ti vetë e pe dhe na the që tek njëri shënohet 11
10 prill, tek tjetri 12 prill.

11 Pë. Po aty me siguri është bo që neve edhe juve e quajmë
12 gabim teknik ose ai punëtori që i ka gravue aty, ato shkronja
13 dhe ato data, ose iu ka dhonë prej dikujt kështu që nuk e ka
14 kuptu dhe nuk e ka ditë. Sepse ata është shumë e vërtetë se
15 kanë vdekë për të njëjtin minutë. Ndodh një minutë ose gjysmë
16 minute ma herët a më vonë, po ka mundësi me vdekë për të
17 njëjtin minutë. Jo më të 11-n, po të dy më të 12-n.

18 Py. Faleminderit për këtë z. Dëshmitar.

19 Dua që të ndryshoj një aspekt tjetër që vjen më vonë që
20 në transkript është në faqen 55, ku ti na ke shpjeguar se kur
21 ke biseduar me Mbrojtjen, me avokatët e Mbrojtjes për herë të
22 dytë dhe aty bëre disa ndryshime lidhur me datën, nga 22-shi
23 në 12 prill.

24 Këtu ti përmende - dhe kjo gjendet në faqen 55 të
25 transkriptit, rreshti 25 dhe faqja tjetër. Ti the pra se edhe

1 anëtarët e familjes u mërzitën që datat u ngatërruan.

2 Tani dua të di se kur ke folur me anëtarët e familjes.

3 Pra, ke folur me anëtarët e familjes së atyre të vdekurve pasi
4 ke fol me Mbrojtjen? Kur dhe përse, nëse ke folur me ta, e ke
5 bërë këtë?

6 Pë. Jo, nuk kam fol edhe nuk kam pasë ndonjë arsye që me fol
7 për ndonjë shqetësim ose për ndonjë - nuk e kam pasë të
8 arsyeshme për me fol. E kom pa se është keq, e kom pa se është
9 gabim, po tash nuk - ose duhet me e ndru atë gurin të tan. Aty
10 duhen pare. Paret si me gjasa familja nuk e ka mundësinë edhe
11 tani për tani ka ngel ashtu. Po me familjarët nuk kam
12 kontaktuar. Se po të kontaktoja me familjarët aty del problem
13 për ndihmë. Del shumë gjana ajo punë.

14 Py. E kuptoj. Dua të citoj përsëri nga transkripti në faqen
15 55, duke filluar te rreshti 24 kur ty të pyetën për
16 korrigjimet që ke bërë në deklaratën që i ke dhënë Mbrojtjes.
17 Ke thënë:

18 "Unë fola me njerëzit e mi në fshat dhe me pjesëtarët e
19 familjes sepse pjesëtarët e familjes u ofenduan që datat ishin
20 bërë gabim. Nuk ishte e qëllimshme. Nuk kishte asgjë të keqe.
21 E kanë ngatërruar, në vend të numrit 2 kanë vënë numrin 1."

22 Dhe mbarojnë fjalët e tua. Sa për të qenë e qartë kjo nuk
23 ka të bëjë - nuk po them që ke bërë gabim të qëllimshëm, e ke
24 bërë me qëllim gabimin. Po përse ke thënë që kam fol, kam
25 bisedu me anëtarët e familjes, ku në fakt po thu se nuk ke

1 fol?

2 Pë. Te përkthimi te neve asht - kam fol me anëtarët e
3 familjes me njënin prej anëtarëve, jo me anëtarët e familjes.
4 Anëtarët e familjes te na në Kosovë, hyn në tanësi. Anëtarët e
5 familjes në shumicë. Kurse kam fol me njërin prej anëtarëve,
6 te na dallon se ke fol me njënin prej atyne, jo me familjen.
7 Ti nëse hyn të thuash, me familjen do të thotë që është se je
8 shkue te shpia dhe ke bisedue, ke bisedu për këtë. Po kemi
9 kontakti me njënin prej atyne çunave, me të cilin e kemi
10 bisedu edhe këtë lloj pune edhe u mbet ashtu. Po jo me
11 familjen, me familjen hyn tani prindërit, hyn gruaja, hyn
12 fëmijët, hyjnë të gjithë. Dhe ka dallim gruaja dhe ka dallim
13 kur të thush po, kemi bisedu me familjarët sepse ai i ka tregu
14 atij që ka pasë nevojë, ose babait, ose vëllaut të madh, ose
15 dikujt tjetër.

16 Py. E kuptoj që nuk fole me të gjithë familjen, po vetëm me
17 një person. Po përse tu desh me fol me një anëtar të kësaj
18 familjeje, të familjes Kurti apo Kaçiu, më fal?

19 Pë. Jo, ka qenë Kaçiu se ish ngatërrim i datës. Ish gabim i
20 datës sepse Bedriu edhe Kaçiu kanë vdekë në të njëjtin moment.
21 Edhe për ata është - edhe kështu që nuk - me thonë të drejtën
22 as ata nuk e kanë vërejt shumë.

23 Py. Në rregull. Faleminderit. Kaq kisha unë për vete.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit Mbrojtësja e Viktimave.

1 Avokati i Mbrojtjes, keni ndonjë pyetje shtesë për t'i
2 bërë dëshmitarit?

3 Z. SHALA: [Përkthim] Kam vetëm një pyetje lidhur me këto
4 dy datat. Dua të sqaroj nëse është data shënuar në varr apo
5 22?

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
7 ka nevojë të justifikoheni.

8 Vazhdoni.

9 Pyetje vijuese z. Shala:

10 Py. Z. Dëshmitar, në pyetjen e Avokatit Mbrojtës të Viktimave
11 ju thatë që keni kontakt me familjarë në lidhje me datën që
12 është bo gabim. Kur thu data apo mendon për datat që kanë qenë
13 të shënuar në gurin e varrit apo për datën që ia ke dhënë
14 Avokatit?

15 Pë. Jo, unë e them për datën që shënon në gurin e varrit.

16 Py. Faleminderit.

17 Z. SHALA: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, nuk kam pyetje
18 të tjera.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit, z. Avokat.

21 Tani të shohim. Znj. Prokurore, keni pyetje shtesë për
22 t'i bërë dëshmitarit?

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, nuk kam.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Avokate e Viktimave?

2 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, nuk kam.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
4 mirë.

5 Atëherë është radha e Trupit Gjykses.

6 Z. Ndreçi, të kanë bërë shumë pyetje - të bënë shumë
7 pyetje avokatët e Mbrojtjes, Prokuroria, Mbrojtësja e
8 Viktimave. Duro dhe pak sepse edhe ne si Trup Gjykses kemi
9 nevojë për disa sqarime të mëtejshme për pak çështje. Për këtë
10 arsye, do t'ia jap fjalën kolegut tim në anën time të majtë.

11 Keni fjalën.

12 Pyetje nga Trupi Gjykses:

13 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit Gjykatëse
14 Kryesuese.

15 Z. Ndreçi, shpresoj që të ta them emrin tamam. Dhe më fal
16 në qoftë se nuk e bëj shumë mirë, nuk ta them shumë mirë
17 emrin.

18 Do t'i kthehem deklaratës që i keni dhënë Mbrojtjes,
19 DSM00062 ku ti shpjegon se e ngave makinën, ishe shoferi i
20 asaj makinës të kuqe të Z. Mustafa, asaj Golfit. Dhe shkuat
21 nga Barileva në Radashevë, kështu ka qenë?

22 Pë. Po.

23 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Çfarë ndodhi - a mund të na
24 thuash - në Radashevë?

25 Pë. Në Radashevc aty ndalum se e pashë një traktor i cili

1 kishte të ngarkum disa ushtarë që vijshin për në Vranidoll.
2 Edhe aty u njoftum se këta po vijnë për Vranidoll. Unë tani
3 zbrita nga makina dhe shpejt e shpejt hypa në atë traktorin, i
4 cili vinte për te pika ku unë u dashke me u kthye.

5 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Dua të mësoj gjithashtu se
6 çfarë ndodhi me Salih Mustafën kur ti e le atë në Radashevc?
7 Sepse në deklaratën që i ke dhënë Mbrojtjes ke thënë: "Po, ai
8 u takua aty me ushtarë të tjerë dhe ata e morën me një makinë
9 tjetër dhe u larguan."

10 E kam kuptuar mirë se aty ishte dhe një makinë tjetër që
11 e përdori z. Mustafa në Radashevc?

12 Pë. Po. Por e kujt ka qenë ajo makinë nuk e di, po ka qenë në
13 atë oborrin aty. Edhe tani thanë se: "Po shkojmë me këtë
14 makinë. Është më e përshtatshme për terrenin e asaj pjese."

15 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Të kujtohet se ç'lloj
16 automjeti ishte, ç'lloj makine?

17 Pë. Jo.

18 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Të kujtohet nëse kishte dhe
19 ushtarë të tjerë në makinë me të? Pra që ishin në makinë
20 bashkë me të?

21 Pë. Po, sigurisht ka pasë, po. Tani se u nguta pak. Besoj se
22 u dashke sepse ai vetëm nuk e besoj se ka shkuar se unë jam
23 kthyer tani. Traktori nuk më ka pritë. Dhe jam ngut shpejt e
24 shpejt, jam hyp në të.

25 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Kur thua, makina të tjera më

1 të përshtatshme për terrenin, e ke fjalën për terrenin prej
2 Radashevcit në Zllash?

3 Pë. Po për atë terren. Megjithëse edhe nuk e kam njoft
4 atëherë, po fatkeqësisht s'e njof as sot.

5 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Sa kohë t'u desh që të
6 kthehesh në Barilevë me traktor?

7 Pë. Jemi nisë nga mbromja me makinë dhe jemi kthyer në
8 mëngjes, mbasi ka zbritë.

9 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra t'u desh nata, gjithë
10 nata për me shku me traktor nga Radasheva në Barilevë?

11 Pë. Nuk ka qenë gjithë nata, sepse gjysmën e natës e kemi
12 kalue në shkuarje deri aty. Pra shkuarja edhe kthimi prej aty,
13 na e kemi bo tanë natën.

14 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Pra nga Barileva
15 në Radashevc, pastaj kthimi me traktor nga Radashevcit në
16 Barilevë, e gjitha kjo zgjati një natë, gjithë nata?

17 Pë. Po.

18 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit.

19 Kam edhe një tjetër pyetje që ka të bëjë me të njëjtën
20 deklaratë, me numër DSM00064. Pyetja është kjo:

21 "Salih Mustafa, a të ka thënë ndonjëherë ndonjë gjë
22 lidhur me situatën në Zllash?" Ishte pyetja.

23 Përgjigjja jote ishte:

24 "Jo. Jo me të po me ushtarë të tjerë. Gjeografikisht, pra
25 kështu nga ana e gjeografisë jemi larg nga Zllashi."

1 Pastaj pyetja tjetër këtu në deklaratë është:

2 "Çfarë diskutuat me ushtarët e tjerë për Zllashin?"

3 Dhe ti pastaj këtu ke thënë:

4 "Me këta ushtarët kemi diskutu sesi ishte aty."

5 Dhe nuk thua më gjëra të tjera.

6 Tani pyetja që kam unë është, çfarë ke diskutuar me këta
7 ushtarët se çfarë kishte në Zllash?

8 Pë. Jo veç me këta, po edhe me të gjithë grupe të tjera ose
9 me persona të tjerë që jemi takue, biseda e vetme, dhe e para
10 dhe e vetme ka qenë, a jeni të gjithë komplet? A ka ndonjë
11 viktimë të re? A keni çka hani dhe a keni çka veshni? Se ka
12 pasë plot që kanë qenë të zhveshun - mos të them në tanësi -
13 po shumë me rroba të këqija. Ka pasë me mbathje veç në çorapa.
14 Dhe u konë brenga ma e madhe e jona dhe diskutimi dhe biseda
15 na ka shkue tanë kohën qysh me mujt me dalë prej këtij dimni.

16 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Po pyetja ime kishte të bënte
17 me situatën në Zllash. E vetmja gjë që diskutuat për Zllashin
18 ishin veshjet dhe ushqimi?

19 Pë. Është shumë e saktë sepse atje asht konë, asht konë shumë
20 larg edhe gjanat ushqimore janë konë shumë të pakta. Tani u
21 konë brenga jonë ma e madhja u konë qysh me mujt ata me u
22 furnizu me ushqime.

23 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit
24 shumë.

25 Nuk kam pyetje të tjera e nderuar Kryetare e Trupit

1 Gjykses.

2 Faleminderit shumë, z. Ndreçi.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit.

5 Z. Ndreçi, kemi ardhur kështu në fund të dëshmisë tuaj.

6 Dëshiroj t'ju falënderoj për përpjekjet e bëra lidhur me

7 dhënien e dëshmisë tuaj. Besoj se do të na ndihmojë që të

8 përpigemi më tej të gjejmë të vërtetën. Ju uroj udhëtim të

9 mbarë për tu kthyer në shtëpi në kthim. Ju falënderoj shumë.

10 Znj. Asistente e Sallës do t'ju shoqërojë tani që të

11 dilni nga salla. Dhe ju rikujtoj që të mos e diskutoni me

12 askënd dëshminë që keni dhënë para Dhomave të Specializuara.

13 Mirupafshim.

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit shumë. Ju përshëndes

15 të gjithëve dhe Salih Mustafën.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nesër

20 do të vijojmë në orën 9.30. Ah do t'ju pyesja, do t'ju pyesja.

21 Pra Dëshmitari 800. Por si zakonisht do t'iu jap fjalën

22 të gjithëve nëse ka ndonjë çështje të rëndësishme për tu

23 diskutuar.

24 Znj. Prokurore, keni fjalën.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk kemi asgjë nga ana jonë, të

1 nderuar Gjykatës.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Mbrojtësja e Viktimave.

4 ZNJ. PUES: [Përkthim] Asgjë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

6 Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuara Gjykatëse. Ka të
8 bëjë me çështje praktike të kalendarit. Siç e shoh tani, duke
9 qenë se po kalojmë nga një person në ditë, kjo do të thotë se
10 do të mbarojmë më datë 6 maj, nëse vijojmë sipas kalendarit të
11 prillit dhe kalendarit të majit.

12 Pyetja që kam ka të bëjë me kalendarin paraprak për
13 periudhën 11 dhe 13 maj. Më herët më ka ardhur një mesazh -
14 pra në fillim të marsit - lidhur me këtë, ku thuhej si vijon:
15 4, 5 dhe 6 maji janë data seance dhe pastaj në javën në vijim
16 11 maj dhe pastaj 12 dhe 13 maj janë ditë rezervë, domethënë
17 ditë paraprake. Mbrojtja ju pyet nuk e di nëse nesër mund të
18 marrim një përgjigje më të saktë lidhur me këtë javë në mënyrë
19 që ta dimë se ku jemi sa i takon asaj jave.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Kërkesa juaj ka të bëjë me javën e 11 majit. Çfarë është më -
22 cilat do të jenë datat e seancave?

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Sepse ka dy data, të cilat janë
24 kështu paraprake, jo përfundimtare, data 12 dhe 13.

25 Pyetja e dytë është kjo. Nëse dëshmitarët do të vazhdojnë

1 me ritmin siç e kemi tani, pra do të thotë që do të mbarojë më
2 datë 6 maj. Çfarë do të ndodhë pas datës 6 maj? Mundësisht
3 cila do të jetë gjëja tjetër që do të ndodhë asaj jave?

4 E them këtë që të bëjmë planifikimet tona sepse dhe
5 anëtarët e ekipit shkojnë e vijnë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
7 japim informacion të mëtejshëm lidhur me këtë. Ne kemi dhënë
8 informacion për muajin prill dhe kemi disa data paraprake për
9 muajin maj. Por në fillim deshëm që të shihnim se me çfarë
10 ritmi do të ecnim me dëshmitarët. Dhe do t'ju informojmë në
11 momentin e duhur. Ju falënderojmë për parashtrimet.

12 Atëherë do të shihemi përsëri nesër në orën 9.30.

13 Këtu ndërpritet seanca.

14 --- Seanca mbyllet në orën 15.52.

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25